



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:

"E Drejtë Civile dhe Tregtare"

Kolegji Universitar "I BIZNESIT"

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.As. Ervis ÇELA

Dr. Holta SEFERI

Shtator / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master i Shkencave në "E drejtë Civile dhe Tregtare"**

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar "I Biznesit"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Drejtësisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në "E drejtë Civile dhe Tregtare"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 651, datë 14.09.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MAS Nr. 6, datë 06.01.2016
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 77, datë 27.10.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite (4 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit viti akademik 2023-2024	6 PAE / 5 PAK
18	Numri i studentëve:	Viti akademik 2022 - 2023 14 studentë; Viti akademik 2023 - 2024 9 studentë;
19	Komente / të tjera:	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

2



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar i Biznesit (në vazhdim KUB), ka aplikuar për vlerësimin e Jashtëm në kuadër të akreditimit për Programin e Studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Civile dhe Tregtare”. Programi i studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “E drejtë Civile dhe Tregtare” (në vazhdim Msc në “E drejtë Civile dhe Tregtare”, është hapur me VKM Nr.651, datë 14.09.2011 dhe akreditimi i parë i këtij programi studimi është bërë me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit (në vazhdim MAS) Nr. 545, datë 13.11.2012. Ky program studimi është riakredituar me 6 vite, me Vendim Nr.77, datë 27.10.2018 të Bordit të Akreditimit, ndaj ky proces është akreditim periodik që kryhet për këtë program studimi. Akreditimi i fundit ka patur një afat prej 6 vitesh akademike. Programi i studimit realizohet me 120 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, niveli 7 i diplomës në KSHK; me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë Master i Shkencave në “E Drejtë Civile dhe Tregtare”. Programi i studimit është hartuar, dhe realizohet konform strategjisë, misionit, vizionit dhe qëllimit të institucionit, në përputhje me bazën ligjore të miratuar nga institucionet kushtetuese të Republikës së Shqipërisë që rregullojnë veprimtarinë e sektorit të arsimit të lartë. Institucioni është i angazhuar në krijimin e një mjedisi mbështetës dhe mundësive të barabarta të personelit për kryerjen e detyrave. Mjediset e punës, laboratorët, sallat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka janë lirisht të aksesueshme nga personeli për kryerjen me profesionalizëm të detyrave të tyre. Vërehet një angazhim i vazhdueshëm nga ana e institucionit për kualifikim e personelit. Në përfundim të këtij aktiviteti GVJ konstatoi që Programi i Studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Civile dhe Tregtare”, zhvillohet si një program i suksesshëm studimi, në përputhje të plotë me një infrastrukturë mësimore që përmbush më së miri kërkesat e studentëve dhe mbështet në standardet bashkëkohore përpjekjet dhe arritjet e personelit në aktivitetin mësimor dhe punën kërkimore-shkencore me studentët. Plani mësimor dhe syllabuset e lëndëve janë profilizuar sipas ofertës së dijeve që i orienton natyrshëm studentët si drejt vazhdimit të cikleve më të larta të diplomimit ashtu edhe drejt tregut të punës.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Civile dhe Tregtare”, filloi me ngritjen e grupit të vlerësimit të jashtëm (GVJ). Grupi i vlerësimit të jashtëm është përzgjedhur nga lista e ekspertëve të jashtëm të vlerësimit, miratuar nga Bordi i Akreditimit. Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) u njoh me DVV, dhe Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB), nëpërmjet sistemit elektronik AMS të ASCAL. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) ka në përbërje: **Prof. Asoc. Ervis Çela** dhe **Dr. Holta Seferi**. Gjatë vizitës në institucion dhe procedurës lidhur me vlerësimin e jashtëm, ky grup pune u asistua nga përfaqëuesja e ASCAL Majlinda Demireli.

GVJ nëpërmjet njohjes dhe shqyrtimit të DVV-së, arriti në reflektimin dhe formulimin e pyetjeve që lidhen me nevojën për qartësimin e gjetjeve në RVB, reflektime në përmbajtjen e tyre, reflektime në hartimin e raportit, saktësimin e vlerësimeve, plotësimin e informacioneve dhe konkretizimin e paraqitjeve. Grupi i vlerësimit të jashtëm për të realizuar këto objektiva, u njoh fillimisht me agjendën e vizitës në institucion, e cila u realizua me datat 27 dhe 28 Shkurt 2024. Gjatë vizitës në Institucion, ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë mbledhjesh për të kryer të gjitha takimet sipas agjendës së planifikuar. Në respekt të agjendës GVJ realizoi një sërë takimesh, intervistash e vëzhgimesh, me Dekanin e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Politike, Përgjegjës të Departamentit të Drejtësisë, me GVB, stafin akademik të programit të studimit, studentët, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, Zyrës së Kurrikulave, Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, Zyrës së Kërkimit Shkencor dhe Projekteve dhe sekretarinë mësimore. Në përfundim GVJ, vëzhgoi dhe mjediset ku zhvillohet programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Civile dhe Tregtare”. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standardeve dhe për çdo kriter që i referohet standardit për programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Civile dhe Tregtare”. Pas shqyrtimit të DVV-së të paraqitur, Raporti i Vlerësimit të jashtëm i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit dhe informacionit të mbledhur gjatë vizitës në Institucion.

Kolegji Universitar “I Biznesit” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 16.07.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 81/12 Prot, datë 16.07.2024. Kolegji Universitar “I Biznesit” njofton më datë 22.07.2024, nëpërmjet shkresës me nr. 326, prot, datë 18.07.2024, “*Dërgohen komente mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm...*”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimi i Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.77, datë 27.10.2018 është:

1. Institucioni të mbështesë më tepër stafin akademik për pjesëmarrje në projekte kërkimore kombëtare apo ndërkombëtare”;

II. Plotësimi i rekomandimit nga Institucioni

Nga shqyrtimi idokumentacionit dhe verifikimi në institucion, rezulton se Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike dhe Departamenti i Drejtësisë në KUB kanë hartuar dhe realizuar një plan masash me qëllim përmbushjen e këtij rekomandimi (*Dok. 15. 1. Relacion mbi masat e mara mbi rekomandimin e BA për programin e studimit*). Në përputhje me aktet bazë të institucionit, kurrikulës, planit mësimor të programit të studimit, si dhe projektet e fituara dhe të aplikuara, KUB ka ofruar mbështetjen e personelit akademik duke krijuar infrastrukturën e nevojshme për të mbështetur akademikisht dhe financiarisht, në angazhimin në projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Prej vitit 2018 dhe deri në vitin akademik 2023-2024, FDSHP ka realizuar një veprimtari mjaft të gjerë përse i përket fushës së projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare. Në bashkëpunim me Zyrën e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve në KUB ka zhvilluar aktivitete nga Marrëveshjet Erasmus +, ka aplikuar dhe fituar në Projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe ka zhvilluar aktivitete me stafin dhe studentët në KUB si dhe me përfaqësues të IAL-të partnere në kuadër të veprimtarisë Erasmus +.

GVJ konstaton se: IAL ka mbështetur stafin akademik për pjesëmarrje në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare duke zbatuar rekomandimin e lënë nga ana e Bordit të Akreditimit, duke nxitur dhe ofruar mundësi personelit akademik për tu angazhuar në projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare duke ecur kështu në të njëjtën linjë me objektivat e KUB dhe planin strategjik të zhvillimit të tij në drejtim të europianizimit dhe ndërkombëtarizimit të veprimtarisë së tij akademike dhe kërkimore-shkencore. GVJ e konsideron këtë rekomandim të përmbushur plotësisht.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Civile dhe Tregtare”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT.

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	KUB ofron këtë program studimi, i cili nuk bie ndesh me interesat kombëtare por ruan dhe konsolidon vlerat akademike dhe ato kulturore, ky program synon formimin e specialistëve në fushën e të drejtës civile dhe tregtare në përputhje me të gjithë kuadrin ligjor në fuqi që rregullon çështjet e kësaj fushe. <i>Dok.7. Rregullore e Programit të Studimit Msc në “E Drejtë Civile dhe Tregtare”, Neni 3’</i> <i>Dok.1. Statuti i KUB, Neni 4;</i> <i>Dok.2. Plan i Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026;</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit konstatohet se është dizenuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë së tij për formimin e specialistëve dhe ekspertëve në fushën e të drejtës civile dhe tregtare. Kolegji Universitar “I Biznesit”, synon t’u japë studentëve një edukim cilësor të qëndrueshëm, për të konkuruar dhe punuar në një treg pune me standartet dhe eksperiencat më të përparura në nivel kombëtar, rajonal dhe në nivel të Bashkimit Evropian, ku synon të shkojë shoqëria shqiptare. <i>Dok.2. Plan i Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026, fq.5-6;</i> <i>Dok.7. Rregullore e Programit të Studimit Msc në “E Drejtë Civile dhe Tregtare”, Neni 3;</i>
Kriteri 3. Programi i	Statuti dhe plani strategjik i KUB specifikojnë qartë drejtimit

studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit.	prioritare duke vënë theksin në faktin se KUB promovon dhe rrit rolin e tij në procesin e zhvillimit ekonomik dhe social përmes transferimit të teknologjive dhe informacionit, në përgjigje globalizimit tregut të punës dhe diversifikimit të madh të arsimit të lartë në Shqipëri. Programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e KUB, në përputhje me fushat e drejtimet akademike të tij. <i>Dok.2. Plani Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026”;</i> <i>Dok.1 Statuti i KUB;</i> <i>Dok.4. Rregullore e KUB;</i>			
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi i studimit zhvillohet në përputhje me Strategjinë kombëtare të zhvillimit të Arsimit të lartë, e cila synon arsim të lartë gjithëpërfshirës që plotëson standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës, dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit. KUB me anë të programit të studimit ka për qëllim të përgatisë specialist për tregun e punës shqiptar dhe ndërkombëtar, të formojë shkencëtar të rinj, të realizojë kualifikime shkencore të stafit akademik, etj. <i>Dok. 2. Plani Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026”;</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit ka vite që ofohet nga KUB, ka kaluar procese të mëparshëm vlerësimi dhe është në përputhje të plotë me interesat kombëtare, strategjitë zhvillimore si dhe me profilin dhe dokumentat strategjitë të IAL.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi
----------	-----------

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

7

Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	KUB është një institucion i arsimit të lartë, me një përvojë 13 vjecare në treg, i akredituar më tej në programet e studimit që ofron, ndaj edhe për këtë program studimi ofron përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën e të drejtës civile dhe tregtare. FDSHP përbëhet nga tre njësi bazë: 1. Departamenti i Drejtësisë; 2. Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare; 3. Departamenti i Shkencave Politike; FDSHP për vitin akademik 2023-2024 ka angazhuar gjithsej 32 staf akademik nga të cilët 21 janë staf akademik efektiv (PAE) nga ku: - 2 kanë titullin “Profesor i Asociuar”; - 14 kanë gradën Dr./PhD; - 5 Asistent Lektorë me Msc; dhe 11 staf akademik me kontratë (PAK) nga ku: - 1 ka titullin “Profesor”; - 7 kanë gradën Dr./PhD; - 3 Asistent Lektorë me Msc; Konstatohet se institucioni në rang institucional por edhe njësie kryesore / bazë, ka kapacitete të plota në fushën e burimeve njerëzore dhe akademike për ofrimin e këtij programi studimi. <i>Dok.116. Tabelat Përmbledhëse ANEKS RVB MSc. Në E drejtë Civile dhe Tregtare;</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit	KUB është i organizuar në dy Fakultete dhe një Kolegj konkretisht: 1. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike; 2. Fakulteti i Ekonomisë; 3. Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale; Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike ku përfshihet edhe programi i studimit ka një eksperiencë prej 13 vitesh. Ky fakultet ofron programe studimi akademike dhe kërkimore në fushën e të




sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	drejtës, marrëdhënieve ndërkombëtare, diplomaci dhe studime evropiane. Fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, si dhe në përputhje të plotë me klasifikimin e programeve të studimit sipas udhëzimeve kombëtare e evropiane <i>Dok. 1. Statuti i KUB;</i> <i>Dok. 6. Rregullore e Departamentit të Drejtësisë;</i> <i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Msc në "E Drejtë Civile dhe Tregtare";</i> <i>Dok. 35. Shkresa dërguar në MAS për kodifikimin e programeve të studimit;</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë brenda Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Politike. GVJ konstaton se programi i studimit ofruar nga KUB është një program studimi i Ciklit të Dytë me 120 kredite, i referohet nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, me formë studimi me kohë të plotë, i ofruar dhe realizuar në gjuhën shqipe, i organizuar me një kohëzgjatje normale 2 vite akademik (4 semestra). Në bazë të shqyrtimit të dokumentave konstatohet që organizimi, struktura dhe përmbajtja e tij janë në përputhje të plotë me fushat e drejtimit akademike të IAL. Objektivat e programit janë në përputhje me objektivat e Fakultetit dhe Departamentit. Nga sa më sipër, vërtetohet se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit 'Master i Shkencave' në 'E Drejtë Civile dhe Tregtare', është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë. <i>Dok. 6. Rregullore e Departamentit të Drejtësisë;</i> <i>Dok.116.Tabelat Përmbledhëse ANEKS RVB Msc. në E drejtë Civile dhe Tregtare;</i> <i>Dok 7. Rregullore e Programit të Studimit Msc në "E Drejtë Civile dhe Tregtare";</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit,	N / A

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

9




cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Referuar RVB dhe vizitës në Institucion, konstatohet se pranë KUB është krijuar Instituti për Studime dhe Aplikime në Biznes (ISAB), që funksionon si një organizatë jofitimprurëse me statusin e një qendre studimore dhe trajnimesh. ISAB është licencuar nga Ministria e Financave (Bordi i Mbikqyrjes Publike të Profesioneve), dhe synon vazhdimësi trajnime gjatë gjithë jetës, të specialistëve, ekspertëve dhe profesionistëve përmes, kurseve afatshkurtër për përditësimin e njohurive, të kapaciteteve dhe ekspertizës profesionale, përgatitjen e profesionistëve për dhënien e Provimeve nga strukturat e Ministrisë së Financave, për specialistët që kanë interes për të Fituar Tituj profesionale, “Kontabilist i Miratuar” ose “Auditues Ligjor”. GVJ konstatoi nga eksplorimi i faqes së internetit dhe rrjeteve sociale, që në vijimësi zhvillon trajnime dhe aktivitete formimi profesional (forume, debate) edhe pas diplomimit të studentëve për shumë çështje të drejtësisë në përgjithësi dhe ato që lidhen me fushën e të drejtës civile dhe tregtare. Në vijim të kësaj, disa prej tyre janë punësuar me kohë të plotë në këto programe studimi duke vijuar aty edhe formimin profesional të vazhduar në trajnimet që KUB ka organizuar. <i>Dok. 60. Program trajnimi ISAB SKK/SNK & Çertifikatë;</i> <i>Dok.100. Urdhër i Ministrit të Drejtësisë që autorizon KUB për realizimin e programit të detyrueshëm të trajnimit për Ndërmjetës të Pasurive të Paluajtshme;</i> <i>Dok. 101. Programi i trajnimit për Ndërmjetës të Pasurive të Paluajtshme & Çertifikatë;</i> <i>Dok. 9. Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës;</i>
Konkluzione	<i>Programi i studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Civile dhe Tregtare” është në përputhje të plotë me fushën akademike të njësisë kryesore dhe asaj bazë.</i> <i>KUB zhvillon trajnime dhe aktivitete formimi profesional (forume, debate) edhe pas diplomimit të studentëve për shumë</i>

	<i>cështje të drejtësisë në përgjithësi dhe ato që lidhen me fushën e të drejtës civile dhe tregtare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësi përkatese dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi efektive brenda institucionit për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi, si dhe analizës periodike të punës së tyre, këto detyra përcaktohen në Rregulloren e KUB dhe Rregulloren e Njesisë Kryesore. Sipas nenit 9 të rregullores së departamentit janë përcaktuar detyrat e drejtuesit të njësië, të koordinatorit të programit, të stafit akademik dhe bashkëpunimit apo koordinimit ndërmjet aktorëve përkatës në procesin akademik. <i>Dok. 5. Rregullore e Njesisë Kryesore FDSHP;</i> <i>Dok. 6. Rregullore e Departamentit të Drejtësisë;</i> <i>Dok. 30. Raporti vjetor i veprimtarive FDSHP, Viti Akademik 2022-2023;</i> <i>Dok. 4. Rregullore e KUB;</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit	Institucioni ka një sërë marrëveshesh me institucione kombëtare, publike e jo, si dhe profesionale ku studentët mund të ndërmarrin aftësim profesional. Janë 43 marrëveshje bashkëpunimi për shkëmbimin e stafit akademik dhe studentëve, në kuadër të programit Erasmus +, ku mund të përmendim Universitetin Assunta në Itali, University of Cadiz Spanjë, University of Applied Sciences Lituani, etj. Këto marrëveshje bashkëpunimi kanë mundësuar shkëmbimin e përvojave akademike të stafit, duke mundësuar dhe rritjen e kapaciteteve akademike. Nëpërmjet

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

11

vendës dhe/ose të huaj.	programit Erasmus+ është mundësuar mobiliteti i stafit akademik dhe studentëve. KUB është partner i konsorciumit të 10 partnerëve Fitues të Projektit të Përbashkët “Creating Opportunities for VET mobility in HOSpitality and Tourism”. <i>Dok. 24. Marrëveshje bashkëpunimi KUB-UAMD;</i> <i>Dok. 23. Model Marrëveshjeje TIP-KUB me IAL/Biznes, Sipërmarrje, OJF;</i> <i>Dok. 21 Lista e marrëveshjeve me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë;</i> <i>Dok. 26 Marrëveshje bashkëpunimi Projekti Co-HOST;</i> <i>Dok. 22. Raport i Përfitueshmërisë të KUB-it nga marrëveshjet e nënshkruara në kuadër të projekteve;</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Lidhur me praktikat ato realizohen në institucione të ndryshme me të cilat KUB ka marrëveshje zyrare, me institucione të tjera që fillohet rishtas bashkëpunimi ose i lihet vetë në dorë studentit të zgjedhë vendin e praktikës sipas dëshirës së tij. Praktikrat janë zhvilluar kryesisht pranë bizneseve, studiove ligjore, zyrave të noterisë, bankave të nivelit të dytë, kompani sigurimi, institucione publike vendore dhe qendrore, kompani auditimi. Në këto marrëveshje janë parashikuar që punëdhënësit të mundësojnë studentët për realizimin me efikasitet të praktikës profesionale dhe në përfundim të nënshkruajnë raportin tip. <i>Dok. 27. Udhëzues për Përgatitjen Praktikës Profesionale;</i> <i>Dok. 116. Tabela 5 - Institucionet dhe Organizatat Bashkëpunuese;</i> <i>Dok. 27.1. Model raporti TIP për kryerjen e Praktikës Profesionale;</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e	Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “E drejtë civile dhe tregtare”, harton raportin vjetor në fund të vitit akademik. Raporti vjetor i hartuar nga njësia bazë (Departamenti i Drejtësisë) përmban elemente të analizës së punës akademike dhe administrative të kësaj njësie, në funksion të procesit mësimor. Pjesë e kësaj analize janë dhe dobishmëritë nga

bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	marrëveshjet e bashkëpunimit, por jo si një komponent i mëvetshëm. Praktikant Mësimor të studentëve mbikëqyren nga punëdhënësit e qendrave ku kryhet praktika, i cili nënshkruan edhe Raportin e Praktikës që paraqitet më tej në KUB për vlerësim nga Komisioni i Vlerësimit. <i>Dok. 28. Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022;</i> <i>Dok. 30. Raporti vjetor i veprimtarive FDSHP, Viti Akademik 2022-2023;</i> <i>Dok. 31. Raporti vjetor i veprimtarive Departamenti i Drejtësisë;</i> <i>Dok. 22. Raport i Përfitueshmërisë të KUB-it nga marrëveshjet e nënshkruara në kuadër të projekteve;</i> <i>Dok. 27. 2. Marrëveshje bashkëpunimi TIP për Praktikant Profesionale;</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se KUB siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

13

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Ky program studimi është pjesë e kurrikulës së FDSHP. Programi përputhet me planin afatgjatë dhe afatmesëm të KUB. Të gjithë elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, dhe veprimtaritë tjera formuese përgjatë tij, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe rezultojnë të vlerësuara në kredite me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit në Master i Shkencave në ‘E Drejtë Civile dhe Tregtare’, relizohet në 2 (dy) vite akademike me 120 kredite ECTS. GVJ konstaton se lëndët në këtë program studimi janë të kategorizuara sipas kategorive të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi (kategorizimi A-E). GVJ konstaton se programi i studimit përmban informacion të plotë dhe të qartë mbi elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit, konkretisht: - Kategoria A: Lëndë bazë- 12 ECTS; - Kategoria B: Lëndë karakterizuese – 70 ECTS; - Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese – 12 ECTS; - Kategoria D: Lëndë plotësuese – 10 ECTS; - Kategoria E: Detyrime përmbyllëse – punimi i diplomës 16 ECTS; <i>Dok. 5. Rregullore e FDSHP;</i> <i>Dok. 6. Rregullore e Departamentit të Drejtësisë;</i> <i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit;</i> <i>Dok. 32. 2. Kurrikula e programit të studimit;</i> <i>Dok. 32.3. Planet Mësimore të programit të studimit;</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik	Referuar planit mësimor programi i studimit Master i Shkencave në ‘E Drejtë Civile dhe Tregtare’, synon formimin e shprehive të veçanta në fushën e së drejtës civile dhe tregtare në nivel teorik por edhe praktik, në zgjidhjen e rasteve potencialisht përpara institucioneve administrative dhe atyre gjyqësore, në mënyrë që studentët të aftësohen edhe në praktikë për ndjekjen e këtyre problematikave dhe zgjidhjen e tyre, këtë synim ka edhe praktika e zhvilluar në institucione të ndryshme për ti aftësuar studentët

të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	për përshtatjen me tregun e punës. Për të vlerësuar dhe stimuluar këtë aspekt të formimit të studentit, KUB e kthen në objektiv të vetin që projektet më të realizuara dhe cilësore ti bëjë pjesë të punimeve dhe prezantimeve në Konferenca Studentore të realizuara jo vetëm me studentët e programit dhe studentët e KUB, por edhe të IAL-ve të tjera me të cilët ka marrëveshje bashkëpunimi. <i>Dok. 44. Studim Tregu për programin e studimit Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare";</i> <i>Dok. 34. Punim studenti nga IAL partnere në Konferencën Studentore;</i> <i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit;</i> <i>Dok. 32.1.Struktura Mësimore programit të studimit;</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit ka të përcaktuara në mënyrë të detajuar ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. Studenti duhet të marrë 120 kredite ECTS në përfundim të ciklit të studimit. Pjesë e këtij program studimi janë dhe kreditet ECTS të përcaktuara për praktikën profesionale, e cila bën pjesë në kategorinë D. Kjo lëndë përbëhet nga 10 ECTS dhe zhvillohet përgjatë vitit të dytë akademik. Në semestrin e dytë të vitit të dytë akademik studentët përgatisin dhe detyrimin përmbyllës në formën e punimit të diplomës, e cila përbëhet nga 16 ECTS. <i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit;</i> <i>Dok.6. Rregullore e Departamentit të Drejtësisë;</i> <i>Dok. 27. Udhëzues për Përgatitjen Praktikës Profesionale;</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të	N / A

arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	N / A
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Studentët që ndjekin programin e studimit, kanë si detyrim të kenë përfunduar studimet universitare në nivel bachelor e të kenë grumbulluar 180 ECTS. KUB është institucion jo-publik i Arsimit të Lartë, i cili organizohet dhe funksionin sipas legjislacionit në fuqi dhe nuk gëzon statusin e IAL të veçantë. Mënyra e pranimi të studentëve është përcaktuar në rregulloren e përgjithshme të kolegjit si dhe në rregulloren e këtij program studimi. Ky program studimi është i organizuar me 120 ECTS, në dy vite akademike, në formën e studimeve me kohë të plotë që në fund të studimeve lëshohet diploma e ciklit të dytë të studimeve (sipas modelit të miratuar nga MAS). <i>Dok. 106. Vendim BA për miratimin e ofertës akademike, financiare dhe programet e pranimi të studentëve;</i> <i>Dok. 109. Lista e studentëve që përfitojnë Bursa Viti Akademik 2022-2023;</i>

	<i>Dok. 4. Rregullore e KUB;</i>
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit në Master i Shkencave në ‘E Drejtë Civile dhe Tregatre’, është i ngjashëm me programet e tjera të të njëjtit cikël studimi të ofruara nga universitetet publike dhe private në vend. Kjo përshtatje mundëson transferimin e studimeve të studentëve brenda vendit, por dhe jashtë vendit meqenëse lëndët janë të organizuara në bazë Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Sipas Nenit 86 “Kodifikimi i programeve të studimit”, të Ligjit 80/2015, KUB, në kuadrin e programit të studimit ‘Master i Shkencave’ në ‘E Drejtë Civile dhe Tregatre’ ka kryer procesin e kodifikimit të programeve (bazuar në ISCED-F 2013) që përcakton <i>kurrikulën dhe rezultatet e të nxënësve të tij, fusha e programit të studimit sipas ISCED-F 2013: Juridik.</i> Në këtë kuadër, pritet të shpallen nga Ministria përgjegjëse për arsimin, të gjitha kodet e programeve për të gjitha IAL. <i>Dok.35. Shkresa dërguar MAS për kodifikimin e programeve të studimit;</i>
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimit MSc në “E Drejtë Civile dhe Tregtare” nuk është program studimi i përbashkët. <i>Dok. 36. Marrëveshje me Webster University, USA;</i> <i>Dok. 37. Marrëveshje bashkëpunimi Alcide de Gasperi University, Poloni;</i>
Konkluzione	<i>Programi i studimit ofrohet në përputhje me kriteret/kërkesat ligjore si përsa i përket organizimit të programit, ndarjes në ECTS ashtu edhe kriteret e pranimit.</i> <i>Programi synon formimin e shprehive të veçanta në fushën e së drejtës civile dhe tregtare në nivel teorik por edhe praktik në zgjidhjen e rasteve potencialisht përpara institucioneve administrative dhe atyre gjyqësore, në mënyrë që studentët të aftësohen edhe në praktikë për ndjekjen e këtyre problematikave</i>

	<i>dhe zgjidhjen e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi																																		
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Programi i studimit Master i Shkencave’ në ‘E Drejtë Civile dhe Tregtare” ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë (njësia bazë) në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Politike. Bazuar Vendimit BA Nr. 03, datë 07.01.2022, KUB është akredituar në nivel Institucional për 4 (katër) vite akademike me afat vlefshmërie deri më 06/01/2026, duke përmbushur kërkesën ligjore për akreditim institucioni. KUB është i përbërë nga tre njësi kryesore: 1. Fakulteti i Ekonomisë; 2. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike; 3. Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale (KSLP) 4. FDSHP për vitin akademik 2023-2024 ka angazhuar gjithsej 32 staf akademik nga të cilët 21 janë staf akademik efektiv (PAE) dhe 11 staf akademik me kontratë (PAK). Departamenti i Drejtësisë përgjegjës për programin e studimit përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas tre viteve akademike që paraqiten si më poshtë: <table><tr><th rowspan="2">Tituj/ grada</th><th colspan="2">2021-2022</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr.</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>2</td><td>-</td><td>1</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr./PhD.</td><td>3</td><td>4</td><td>4</td><td>4</td><td>6</td><td>2</td></tr></table>	Tituj/ grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	-	-	-	2	-	1	Prof. Asoc.	-	-	-	-	-	-	Dr./PhD.	3	4	4	4	6	2
Tituj/ grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024																														
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																													
Prof.Dr.	-	-	-	2	-	1																													
Prof. Asoc.	-	-	-	-	-	-																													
Dr./PhD.	3	4	4	4	6	2																													

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

18

	<table><tr><td>Msc.</td><td>4</td><td>3</td><td>3</td><td>2</td><td>1</td><td>3</td></tr><tr><td>Totali</td><td>7</td><td>7</td><td>7</td><td>8</td><td>7</td><td>6</td></tr></table>	Msc.	4	3	3	2	1	3	Totali	7	7	7	8	7	6
Msc.	4	3	3	2	1	3									
Totali	7	7	7	8	7	6									
	<i>Dok. 20. Organigrama e KUB & Vendimi i Senatit Akademik;</i> <i>Dok. 32. 2. Kurrikula e programit të studimit;</i> <i>Dok. 116. Tabelat Përmbledhëse Aneks RVB Msc në “E drejtë Civile dhe Tregtare” Tab.1-10;</i>														
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Njësia kryesore dhe njësia bazë, pranë të cilit ofrohet dhe ky program studimi janë të organizuara në aspektin strukturor-akademik, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e arsimit të lartë. Gjatë vizitës në IAL, GVJ u informua se në programin e studimit, studenti krahas seancave në auditor kryen praktikë në një institucion organizatë kompani, i mbikqyrur nga pedagogu përgjegjës i departamentit, por nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se Fakulteti dhe departamenti, nuk kanë personel ndihmës akademik / administrativ. <u>GVJ rekomandon që institucioni të angazhojë personel ndihmës akademik për realizimin e praktikave mësimore.</u> <i>Dok. 116. 2. Lista e Personelit Akademik për Njësine Bazë, Titujt/Gradat;</i> <i>Dok. 116. 4. Ngarkesa Totale e Personelit Akademik të Programit;</i> <i>Dok. 27. Udhëzues për Përgatitjen Praktikës Profesionale. 1.Model raporti TIP për kryerjen e praktikës. 2.Marrëveshje bashkëpunimi TIP për Praktikën Profesionale. 3.Tabela e vlerësimit të Praktikës Profesionale;</i> <i>Dok. 116. 5 - Institucionet dhe Organizatat Bashkëpunuese;</i>														
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinators të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe	Drejtuesi i departamentit është koordinatori i programit të studimit i cili ka detyra të mirëpërcaktuara në aktet e brendshme të institucionit. Ai mbikqyr veprimtaritë mësimore shkencore në përputhje me planin vjetor të stafit, dhe monitoron gjithë procesin e përgatitjes, rishikimit, përmirësimit dhe realizimit të programit të studimit. Referuar RVB, FDSHP ka përcaktuar dhe rolin e pedagogëve “Tutor” të cilët paraqiten me miratimin e orarit mësimor dhe shpallen në ambiente publike për studentët që														

zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	ndjekin studimet gjatë vitit akademik përkatës dhe kontribuojnë lidhur me aktivitetet kurrikulare dhe ekstra-kurrikulare. <i>Dok. 6. Rregullore e Departamentit të Drejtësisë;</i> <i>Dok. 32. 5. Model orari mësimor i programit të studimit;</i>			
Konkluzione	<i>Njësia kryesore dhe bazë përgjegjëse për zbatimin dhe mbikqyrjen e programit të studimit përmbushin kriteret ligjore për numrin e stafit me tituj dhe grada si dhe përsa i përket akteve të tjera të brendshme rregullatore. Njësia kryesore ka caktuar koordinatorin e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Bazuar tek shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në dosjen e vetë-vlerësimit si dhe vizitën në institucion, GVJ evidentoi se njësia kryesore dhe njësia bazë që janë përgjegjëse për këtë program studimi disponojnë dhe i vënë në dispozicion studentëve të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Kjo doli në pah sidomos nga takimi me studentët. Departamenti i Drejtësisë, si njësia bazë, përgjegjëse për programin e studimit programon, organizon dhe bashkërendon veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore në fushën e të drejtës civile dhe tregtare. <i>Dok. 6. Rregullore e Departamentit të Drejtësisë;</i> <i>Dok. 32. 3. Planet Mësimore të programit të studimit;</i> <i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit;</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin	Bazuar në ligjin 80/2015 dhe aktet nën ligjore në fuqi, IAL ofron programe studimi të organizuara në module e të vlerësuara në

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

20

mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	kredite ECTS, plani mësimor për programin e studimit në shqyrtim pasqyron zhvillimin e programit në 2 vite akademike, 4 semestra, me 120 kredite. Planin përmban informacionet për lëndët/modulet të vlerësuara me kredite sipas sistemit ECTS si dhe siguron një shpërndarje të balancuar të ngarkesës mësimore ndërmjet semestrave në zbatim të udhëzimeve të MAS. <i>Dok. 32. 3. Planet Mësimore të programit të studimit;</i> <i>Dok. 116. 4. Ngarkesa Totale Personeli Akademik i Programit të Studimit;</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Bazuar në ligjin 80/2015 dhe aktet nën ligjore në fuqi, programin e studimit mund ta ndjekin studentë të cilët zotërojnë së paku diplomën “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS. GVJ konstaton se rregullorja e Programit të studimit (neni 5) në Master i Shkencave në “E Drejtë Civile dhe Tregtare”, ka të përcaktuar qartë dhe në mënyrë eksplicitete të gjitha informacionet e nevojshme për studentët duke filluar nga kriteret specifike të pranimit, strukturën e programit të studimit, objektivat e programit të studimit, kreditet, systemin e vlerësimit, transferimin dhe ekuivalentimin e lëndëve. Informacioni është në dispozicion të studentëve që në momentin e regjistrimit të tyre dhe ofrohet në vijimësi nga struktura akademike dhe administrative e institucionit. <i>Dok. 4. Rregullore e KUB, neni 63 dhe 66;</i> <i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit, nenet 5-6-12;</i> <i>Dok. 39. Rregullore për ekuivalentimin e studimeve;</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë	Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacion mbi njohuritë që ofrohen, e rezultatet e pritshme të mësimnxënies. Specifikisht, në planin mësimor të programit pasqyrohen të gjithë elementët në përputhje me aktet nënligjore në fuqi si: emërtimi i lëndës, semestri kur zhvillohet, ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit në ECTS, ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime dhe seanca të praktikave të zhvilluara jashtë auditorit, raporti leksion/seminar, ushtrime, praktika mësimore, mënyra e kontrollit të dijeve si dhe totali i krediteve. Të gjitha këto informacione, u vihen studentëve në dispozicion

auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	përgjatë të gjithë ciklit të studimeve. Programet mësimore përditësohen cdo vit nga pedagogët e secilës lëndë dhe përshaten me ndryshimet ligjore të fushës, rastet praktike të gjykatave si dhe nevojat/interesat e studentëve. <i>Dok. 116. 14 - Model Syllabus, elementët sipas VKM Nr. 41/2018;</i> <i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Msc. në "E Drejtë Civile dhe Tregtare";</i>			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Departamenti i Drejtësisë si njësi bazë për këtë program studimi, diskuton në mbledhjet e kësaj njësie përmirësimin e programeve të lëndëve, në lidhje me literaturën që do të përdoret dhe temave që lidhen me aktualitetin. Çdo vit kërkohet përmirësim i syllabuseve, të cilat duhet të miratohen nga Senati Akademik. <i>Dok. 5. Rregullore e Njesisë Kryesore FDSHP;</i> <i>Dok. 46. Raporti vjetor i NJSBC Viti Akademik 2022-2023;</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se Departamenti i Drejtësisë, si njësi bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, ka të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit të cilat jo vetëm janë publike në faqen e internetit por u bëhen të njohura studentëve që në momentin e aplikimit dhe më tej përgjatë cdo kursi/lënde.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe	Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive të programit të studimit në Master i Shkencave në E Drejtë Civile dhe Tregtare, është në përputhje me fushën e studimit që ofron programi. Ky program

praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	përmes lëndëve që ofron, literaturës përkatëse mundëson që studentët të kenë mundësi të thellojnë njohuritë e tyre. Aktivitetet dhe veprimtaritë që përfshihen në programin e studimeve ndihmojnë në zhvillimin e aftësive, përmes një kombinimi të mësimin teorik dhe praktik, duke i përgatitur ata për sfidat e studimeve të mëtejshme ose për t'i bërë ata konkurrues në tregun e punës. Përmbajtja e kurrikulës së këtij programi studimi mundëson njohuri bazë dhe të thelluara, dhe është në përputhje me qëllimin dhe objektivat e këtij programi, të cilat janë të parashikuara dhe në rregulloren e tij. <i>Dok. 32. 3. Planet Mësimore të programit të studimit;</i> <i>Dok. 27. Udhëzues për Përgatitjen Praktikës Profesionale;</i> <i>Dok. 42. Raporti vjetor i veprimtarive të ZSKK. 1.Të dhënat e punësimit të studentëve të KUB (Viti akademik 2022-2023);</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.	Plani mësimor ka të përcaktuar qartë organizimin kohor të programit, duke specifikuar se si lëndët janë të shpërndara gjatë viteve dhe semestrave. Shpërndarja kohore ndihmon në përgatitjen graduale të studentëve për njohuritë dhe aftësitë që do të zhvillojnë, duke e shpërndarë ngarkesën në gjithë ciklin. Organizimi i veprimtarisë mësimore shtrihet në 4 (katër) semestra me kohëzgjatje normale 15 javë. Të gjitha lëndët e këtij programi studimi kanë të përcaktuar numrin e krediteve, shpërndarjen e orëve mësimore, formën e orëve mësimore (leksione/seminare), objektivat e mësimdhënies dhe mësimnxënies, format e kontrollit të njohurive, komponentët e vlerësimit dhe shpërndarjen e tyre përgjatë zhvillimit të lëndës. <i>Dok. 32. 3. Planet Mësimore të programit të studimit;</i> <i>Dok. 116. 9. Plani Mësimor i Ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E);</i> <i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Msc në “E Drejtë Civile dhe Tregtare”;</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e	Referuar RVB dhe planit mësimor, konstatohet se struktura e programit të studimit përfshin lëndë dhe module që ose janë vazhdimësi e thelluar ose e avancuar e njohurive të marra në nivele të mëparshme studimi. Shpërndarja e ngarkesës akademike për studentët është e balancuar

përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	përgjatë të katër semestrave akademik. Përgjatë një viti akademik janë shpërndarë 60 ECTS. Në semestrin e katër realizohet praktika profesionale dhe detyrimi përmbyllës. <u>Duhet parë përshtatshmeria e disa lëndëve të cilat dalin jashtë profilit të këtij program studimi.</u> <i>Sic eshte lenda ‘E drejte nderkombetare penale’ e cila gjykojme qe eshte jashte profilit, kjo lende mund te zevendesohet me lenden ‘E drejta nderkombetare private’ e cila ne programin e saj pershtatet profilit te ketij program studimi</i> <i>Dok. 32. 3. Planet Mësimore të programit të studimit;</i> <i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Msc në “E Drejtë Civile dhe Tregtare;</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Raportet midis formimit teorik dhe praktik të programit të studimit burojnë nga objektivat e tij. Objektivat kryesore të programit lidhen me dhënien e njohurive e aftësive praktike mbi të drejtën civile dhe tregtare. Vlerësimi me ECTS i lëndëve në programin e studimit mundëson krahasimin e njohurive mes programeve të ngjashme e lehtëson transferimin e krediteve/studimeve. Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në 5 kategori: lëndë bazë që përcaktojnë formimin e përgjithshëm; lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij; lëndë ndërdisiplinore (integruese) në një ose më shumë grupe disiplinash të ngjashme apo integruese me disiplinat karakterizuese; lëndë plotësuese, të fokusuara në përfitim të aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike dhe telematike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikat profesionale të zhvilluara pranë subjekteve publike e private, sipas marrëveshjeve të nënshkruara; detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës;

	<i>Dok. 116. 9. Plani Mësimor i Ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E);</i> <i>Dok.42 Raporti vjetor i veprimtarive të ZSKK;</i> <i>Dok. 41. Plani vjetor i ZSKK;</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Njësia bazë dhe njësia kryesore, në fillim të çdo viti akademik kanë një proces ku analizojnë të dhënat e përfuara nga analiza e vitit paraardhës si dhe mënyrat se si ato mund të reflektohen, ndër të tjera, në përditësimin e silabuseve. Nga analiza e dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ vëren se ky proces ishte i mirë-rregulluar dhe serioz. Cdo vit diskutohet përmirësimi i programit për tu përshtatur me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet e fundit në fushën e të drejtës civile dhe tregtare. <i>Dok. 32. 4. Syllabus-et e Lëndëve/Moduleve të programit të studimit;</i> <i>Dok. 47. Relacion për Realizimin e Buxhetit 2022 dhe Planifikimi 2023 KUB;</i> <i>Dok. 48. Lista e teksteve të reja për programin e studimit;</i> <i>Dok. 90. Marrëveshje bashkëpunimi JSTOR/e-biblioteka;</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi synon t'iu ofrojë studentëve aftësim praktik nëpërmjet mësimdhënies dhe lidhjes me aktorët e tregut të punës që të jenë të aftë të analizojnë fenomenet në të drejtën civile dhe tregtare. Programi i studimit ofron dhënie të dijeve, aftësive dhe kompetencave bashkëkohore edhe sipas trajtimeve dhe koncepteve bashkëkohore evropiane (kjo për shkak të botimeve të teksteve të përkthyer) dhe për shkak të angazhimit të personelit akademik me eksperiencë jo vetëm në mësimdhënie por edhe në fusha praktike të së drejtës civile dhe tregtare, në përshtatje me kërkesat e tregut të punës. <i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit";</i> <i>Dok. 44. Studim Tregu për programin e studimit Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare";</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit	Referuar RVB, programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë formimin e duhur teorik e praktik.

mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi synon të formojë specialist në fushën e së drejtës civile dhe tregtare, duke i vënë një theks të vecantë kompetencave dhe njohurive që lidhen me këto drejtime. Përfshirja në platformën GRADUA, i cili u financua nga Programi Erasmus+ i Bashkimit Evropian, ofroi një mbështetje për universitetet shqiptare duke krijuar një model të integruar kërkesë-ofertë punësimi, të bazuar mbi të dhënat e databazës së të diplomuarve, përmes mbledhjes së të dhënave lidhur me performancën e tyre lehtësimin e bashkëpunimit ndërmjet IAL-ve dhe bizneseve lehtësimin e pozicionimit të të diplomuarve në tregun e punës. <i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Msc në "E Drejtë Civile dhe Tregtare";</i> <i>Dok. 44. Studim Tregu për programin e studimit Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare";</i> <i>Dok. 116. Tabela. 21. Cilësia në hyrje dhe në dalje e Studentëve. Tabela 23 - Të dhëna për Diplomimin dhe Punësimin e Studentëve;</i> <i>Dok. 49. Marrëveshja dhe regjistrimi në Platformën GRADUA;</i>			
Konkluzione	<i>Struktura dhe organizimi i programit janë në tërësi në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Programi i studimit ofron dhënien e dijeve, aftësive dhe kompetencave bashkëkohore edhe sipas trajtimeve dhe koncepteve bashkëkohore evropiane (kjo për shkak të botimeve të teksteve të përkthyer në një vlerë e cmuar kjo në arsimin e lartë shqiptar) dhe për shkak të angazhimit të personelit akademik me eskepriencë jo vetëm në mësimdhënie por edhe në fusha praktike të së drejtës civile dhe asaj tregtare, në përshtatje me kërkesat e tregut të punës. <u>GVJ rekomandon rishikimin e disa lëndëve të cila dalin jashtë profilit të programit.</u></i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

26

studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	KUB ka shumë bashkëpunime me partnerë, ku nga bashkëpunimi me to, mbledh informacion mbi përshtatshmërinë e programit të studimit dhe nevojave të tregut të punës. Përmirësimi i kurrikulës në këtë program studimi është realizuar përmes bashkëpunimit me stafin akademik dhe bashkëpunëtorëve të tregut të punës. KUB sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe partneritetit, jo vetëm zhvillon praktikat profesionale, por edhe merr feedback nga ekspertët e këtyre institucioneve mbi cilësinë e programit të studimit dhe kërkesat e tregut të punës. <i>Dok. 44. Studim Tregu për programin e studimit Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare";</i> <i>Dok. 116. 5. Institucionet dhe Organizatat Bashkëpunuese;</i> <i>Dok. 42.1. Të dhënat e punësimit të studentëve, (Viti akademik 2022-2023);</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Studentët janë të përfshirë në të gjitha nivelet e vendimmarrjes së IAL, nga senati deri në njësinë bazë. Ata përfaqësohen në Senatin Akademik, NJSBC dhe GVB, gjithashtu studentët më të dalluar të përfshihen në kërkimin shkencor, botimet akademike, revistat shkencore, konferencat dhe workshopet, aktivitetet e tjera kërkimore-shkencore, etj. Mendimet dhe opinionet e studentëve janë pjesë e pyetësorëve dhe sondazheve, që realizohen nga zyrat përkatëse të institucionit. Aktet e brendshme të institucionit kanë të përcaktuara të drejtat e studentëve. <i>Dok. 42. Raporti vjetor i veprimtarive të ZSKK;</i> <i>Dok. 41. Plani vjetor i ZSKK;</i> <i>Dok. 13. Rregullore e Senatit Akademik të KUB;</i> <i>Dok. 116. 24. Të dhëna për Anëtarët e NjBSC;</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në	Institucioni dhe njësia bazë (Departamenti i Drejtësisë) për këtë program studimi realizon takime me grupet e profesionistëve të fushave të ndryshme për të marrë mendimin dhe vlerësimin e tyre për komponentët e procesit mësimor dhe për shërbimet që mund të ofrohen nga institucioni. Gjithashtu njësia bazë në të cilën ofrohet ky program studimi, përditëson përmbajtjen e programit dhe në

fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	bazë të akteve të brendshme të institucionit, duke marrë në konsideratë dhe vlerësimet e studentëve. <i>Dok. 116. 5 – Institucionet dhe Organizatat Bashkëpunuese;</i> <i>Dok. 44. Studim Tregu për programin e studimit Msc në “E drejtë Civile dhe Tregtare”;</i>			
Konkluzione	<i>KUB ka marrëdhënie të konsoliduara me aktorët e tregut të punës të cilët, ndër të tjera mund të angazhohen edhe në procesion e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit përcakton në mënyrë shumë të qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit në fushën e së drejtës civile dhe tregtare si nga ana teorike edhe ajo praktike. Gjithashtu është në përputhje me objektivat dhe mundësitë e institucionit. Në të njëjtën linjë është edhe kërkimi shkencor, në përputhje këto me objektivat e institucionit kjo konstatohet nga programet e lëndëve të ndryshme si dhe nga aktivitetet kërkimore dhe profesionale që KUB organizon periodikisht. Objekti kryesor i programit të studimit të ciklit të dytë Msc në “E Drejtë Civile dhe Tregtare” është formimi i ekspertëve dhe specialistëve në këtë fushë duke iu dhënë studentëve njohuri të theluara specifike ligjore dhe profesionale në fushën e të drejtës civile dhe tregtare si dhe duke i përgatitur ata me aftësi aplikative në këtë fushë. <i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Msc në “E Drejtë Civile dhe Tregtare”;</i> <i>Dok. 2. Plan i Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026;</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.asc.al

28

	<i>Dok. 32. 3. Planet Mësimore të programit të studimit;</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Programi i studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Civile dhe Tregtare” përbëhet nga lëndët dhe modulet e tyre të cilat kanë qëllimet, objektivat, dijet dhe aftësitë profesionale që studentët pritët të përfitojnë në përfundim të studimeve. Programi mbështetet në njohuritë e përfituara në ciklin e parë të studimeve dhe synon përfundimin e dijeve, shkathtësive e kompetencave në përputhje me nevojat e tregut të punës. Gjithashtu edhe aktivitetet e organizuara në kuadrin e zgjerimit dhe/ose thellimit të njohurive në të drejtën civile, tregtare, gjejnë mbështetje dhe koordinim të plotë nga Departamenti dhe KUB. <i>Dok. 30. Raporti vjetor i veprimtarive FDSHP, Viti Akademik 2022-2023;</i> <i>Dok. 31. Raporti vjetor i veprimtarive Departamenti i Drejtësisë;</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Në të gjitha aktivitetet e organizuara nga Departamenti dhe KUB në përgjithësi, kryefjala janë studentët dhe interesat e tyre profesionale, zhvillimi i karrierës pas ciklit të studimeve, mundësitë për të krijuar kontakte të reja të dobishme me profesionistë të fushës, njohja me mundësitë për rritje të mëtejshme profesionale dhe akademike, etj. Këtë gjë e konfirmuan maksimalisht edhe studentët në takimin e zhvilluar, të cilët jo vetëm që kanë qënë të angazhuar nga stafi pedagogjik në forume diskutimi por kanë organizuar edhe vetë aktivitete të interesit të tyre profesional, të facilituar nga KUB si nga ana e burimeve njërëzore edhe nga ajo financiare. <i>Dok. 33. Program i Konferencës Shkencore Studentore;</i> <i>Dok. 42. Raporti vjetor i veprimtarive të ZSKK;</i> <i>Dok. 77. Raport mbi aktivitetet e zhvilluara me stafin dhe studentët në KUB dhe me përfaqësues të IAL-të partnere në kuadër të veprimtarisë Erasmus+;</i> <i>Dok. 69. Raporti Vjetor i Punës Kërkimore Shkencore dhe Projektet, KUB;</i>
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore,	Referuar RVB stafi akademik është i inkurajuar të hulumtojë e publikojë dhe në bazë të performancës të marrin grandet e tyre kërkimore. Departamenti mbështetet financiarisht nga institucioni i

njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	cili ofron fonde për aktivitetet kërkimore e shkencore. KUB ka alokuar buxhet për të financuar të gjithë artikujt e stafit akademik që botohen në Revista me faktor impakti dhe SCOPUS, në kuadër të kualifikimit dhe promovimit të stafit për të fituar grada dhe tituj akademike. <i>Dok. 70. Rregullore e zyrës së Kërkimit Shkencor dhe Projekteve;</i> <i>Dok. 57. Vendim BA për mbështetjen financiare për Kërkimin Shkencor të stafit akademik KUB;</i> <i>Dok. 47. Relacion për Realizimin e Buxhetit 2022 dhe Planifikimi 2023 KUB;</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vëren se programi i studimit është në përputhje me objektivat e institucionit, menaxhohet me efektivitet nga njësia bazë dhe ka në dispozicion burimet e nevojshme për të qenë efektiv.</i> <i>Programi përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit në fushën e së drejtës civile dhe tregtare si nga ana teorike edhe ajo praktike. Aktivitetet e organizuara në kuadrin e zgjerimit dhe/ose thellimit të njohurive në të drejtën civile dhe tregtare, gjejnë mbështetje dhe koordinim të plotë nga Departamenti dhe KUB.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me	Aktualisht sic edhe u informuam, përpjekja kryesore është e lidhur me angazhimin e personelit akademik në publikime në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare apo edhe pjesëmarrje në konferenca shkencore. Kjo gjë realizohet edhe me angazhimin e studentëve në forume diskutimesh akademike ku së bashku me pedagogët e tyre parashtrajnë qasjet e ndryshme lidhur me




struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	fenomene shkencore, duke përfshirë edhe raste apo qasje praktike. KUB, mbështet financiarisht personelin akademik për materialet e referatet e përgatitura dhe prezantuar në Konferencat Shkencore Kombëtare dhe Ndërkombëtare të realizuara nga KUB, duke ia botuar falas, të gjitha punimet në Proceedings dhe në Revisten Shkencore për studime profesionale, të botuar nga KUB. <i>Dok.102. Relacion për Konferencat Kombëtare dhe Ndërkombëtare që janë zhvilluar në KUB përgjatë viteve akademike 2020-2023;</i> <i>Dok. 103 Rankimi i Universiteteve për punën shkencore, 2022;</i> <i>Dok. 81. Proceedings të Konferencës së IX-të Shkencore Ndërkombëtare KUB;</i> <i>Dok. 116. 19. Të dhëna për Kërkimin Shkencor të Personelit Akademik;</i> <i>Dok. 116. 20. Të dhëna për Bashkëpunimin Kombëtar dhe Ndërkombëtar të Fakultetit;</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Nga vizita në institucion, GVJ vuri re se njësia bazë kishte interes dhe përqasje proaktive për të bashkëpunuar me aktorët e tregut të punës sidomos përsa i përket punësimit të të diplomuarve të programit të studimit. Referuar RVB, dy pedagogë janë angazhuar si udhëheqës i një grupi studentësh në konkursin University Law Competition 2023 2nd Edition, të organizuar nga Halimi Foundation Institute me pjesëmarrjen e mbi 10 Fakulteteve të Drejtësisë të Universiteteve brenda vendit. <i>Dok. 77. Raport mbi aktivitetet e zhvilluara me stafin dhe studentët në KUB dhe me përfaqësues të IAL-të partnere në kuadër të veprimtarisë Erasmus+;</i> <i>Dok. 76. Raport i planifikimit të aktiviteve të KUB nga Marrëveshjet Erasmus +;</i> <i>Dok.118. Projekti University Law Competition 2023 2nd Edition;</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe	GVJ vëren se, KUB ka zhvilluar aktivitete si: konferenca, leksione të hapura, seminare, forume dhe tryeza debati me të ftuar vendas apo të huaj ku kanë marrë pjesë stafi akademik dhe studentë të këtij programi studimi. Gjithashtu, ka patur lektorë të huaj nga universitete partnere, nga institucione ndërkombëtare si dhe lektorë dhe shkëmbime në kuadër të Erasmus+. Këto aktivitete forcojnë

studentët për arritjen e objektivave.	kontaktet dhe rrisin mundësinë e bashkëpunimit në projekte dhe aktivitete vendore dhe ndërkombëtare. <i>Dok. 102. Relacion për Konferencat Kombëtare dhe Ndërkombëtare KUB;</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Studentët që janë diplomuar në këtë program studimi janë kryesisht të punësuar. Programi i studimit Master i Shkencave në “E drejtë civile dhe tregtare” përmban lëndë që mundësojnë njohuri të thelluara në fushat respektive të së drejtës. Njohuritë e ofruara në këtë program studimi lidhen me tregun kombëtar dhe ndërkombëtar. Studentët të cilët përfundojnë me sukses studimet në këtë program studimi mund të punësohen si ekspertë të fushës së së drejtës civile dhe tregtare, zyra avokatie dhe konsulence ligjore, zyrë noterie, sektorë të ndryshëm publikë dhe privatë etj. <i>Dok. 42. Të dhënat e punësimit të studentëve të KUB, Viti akademik 2022-2023);</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Referaur RVB dhe takimeve në institucion, KUB sipas Urdhërit të Ministrit të Drejtësisë Nr. 619, datë 23.11.2022, ka fituar të drejtën për të kryer trajnime dhe kualifikime me Kandidatët që kërkojnë të Licencohen për Profesionin e Ndërmjetësit të Pasurive të Paluajtshme, në bazë të Ligjit Nr. 9, dt. 27.01.2022 “Për Profesionin e Ndërmjetësit të Pasurive të Paluajtshme”. Studentët të cilët përfundojnë me sukses studimet në këtë program studimi mund të punësohen si ekspertë të fushës së së drejtës civile dhe tregtare, zyra avokatie dhe konsulence ligjore, zyrë noterie, sektorë të ndryshëm publikë dhe privatë etj. <i>Dok. 100. Urdhër i Ministrit të Drejtësisë në RSh, që autorizon KUB për realizimin e “Programit të detyrueshem të trajnimit për NPP”;</i> <i>Dok. 101. Program trajnimi për Ndërmjetës të Pasurive të Paluajtshme & Çertifikatë;</i>
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me	Kurrikula e studimit, përmban edhe lëndë me spektër ndërkombëtar si: E Drejtë Tregtare ndërkombëtare, E Drejta penale ndërkombëtare, Zgjidhje e Mosmarrëveshjeve Ndërkombëtare, me

aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	qëllim që studentët të formohen rreth çështjeve me elementë ndërkombëtare si nga ana teorike edhe ajo praktike, në reflektim edhe të programeve mëimore të universiteteve të huaja dhe të rregulloreve apo direktivave në nivel BE për formimin/aftësimin profesional. <i>Dok. 2. Plani Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026;</i>			
Konkluzione	GVJ vëren se programi i studimit ofron mundësi për kërkim shkencor dhe në këtë kuadër bashkëpunim me tregun e punës. <i>Departamenti mbështet të gjitha projektet kërkimore-shkencore që lidhen me fushën e së drejtës në përgjithësi dhe në fushën civile dhe tregtare në vecanti, kryesisht nga personeli akademik në publikime në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare apo edhe pjesëmarrje në konferenca shkencore dhe në angazhimin e studentëve në forume diskutimesh akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe	Si pjesë e Departmentit të Drejtësisë, programi përpiqet të harmonizojë metodat bashkohore të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të njohurive. Bazuar në Rregulloren e programit

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

33

transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	të studimit format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të njohurive përfshijnë: leksione, seminare/orë laboratorike, detyra/projekte kursi, praktike profesionale, tema diplome/provim formimi. Çdo vit akademik, departamenti i Drejtësisë përgatit dosjen e plotë të programit të studimit. Në dosje përfshihen planet mësimore, struktura e vitit akademik, planet e ngarkesave mësimore, planet kalendare, plani i performancës akademike, etj. <i>Dok. 32. 1. Struktura Mësimore e programit të studimit;</i> <i>Dok. 32. 2. Kurrikula e programit të studimit;</i> <i>Dok. 32. 3. Planet Mësimore të programit të studimit;</i> <i>Dok. 65. Vlerësim Performance stafi_TIP;</i> <i>Dok. 116. 14. Model Syllabus, elementët sipas VKM Nr. 41/2018;</i> <i>Dok. 32. 4. Syllabus-et e Lëndëve/Moduleve të programit të studimit;</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi, mundëson përmes metodave interaktive përfshirjen e studentëve gjatë procesit mësimor. Studentët marrin pjesë në aktivitete kërkimore dhe shkencore të organizara nga stafi akademik, por edhe kanë mundësi të pjesëmarrjes në leksionet e hapura me pedagogë të ftuar nga institucione vendase dhe të huaja <i>Dok. 116. 17. Të dhëna Platformat Online/Struktura e IT/Biblioteka online;</i> <i>Dok. 45. Plani vjetor i NJSBC Viti Akademik 2022-2023;</i> <i>Dok. 46. Raporti vjetor i NJSBC Viti Akademik 2022-2023;</i> <i>Dok. 46. 3. Format Pyetësori i Studentit KUB;</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	KUB organizon trainime të rregullta vjetore për stafin akademik dhe bashkë me departamentin përkatës mbështet përhapjen e metodave të suksesshme mësimore ndërmjet stafit akademik, duke synuar rritjen e vazhdueshme profesionale të pedagogëve dhe ofrimin e stimuljeve për përmirësimin profesional. KUB në politikën e tij mbështetëse ka mbështetur personelin akademik nëpërmjet programit Erasmus+, ku shkojnë për trajnime çdo vit krahas studentëve edhe pedagogë, përfshirë edhe pedagogë nga ky

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

34

	program studimi pranë Universiteteve perëndimore, me të cilat KUB ka marrëveshje. Çdo vit akademik zhvillohet edhe një pyetësor dhe përgatitet analiza përkatese e tij, për personelin akademik dhe studentët e KUB nga NJSBC. <i>Dok. 46. Raporti vjetor i NJSBC Viti Akademik 2022-2023;</i> <i>Dok. 46. 3. Format Pyetësori i Studentit KUB;</i> <i>Dok. 59. Marrëveshje bashkëpunimi KUB-IQE;</i> <i>Dok. 59. Marrëveshje bashkëpunimi KUB-IQE;</i> <i>Dok. 59. 2. Format Pyetësori i Studentëve IQE;</i> <i>Dok. 59. 4. Raporti i IQE për studentët, 2023;</i> <i>Dok. 59. 1. Format Pyetësori i Stafit IQE;</i> <i>Dok. 59. 3. Raporti i IQE për Stafin, 2023;</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. Me anë të formave të përdorura për shpjegimin e koncepteve dhe dhënien e njohurive si dhe me format e kontrollit të dijeve mundësohet një mësimdhënie interactive dhe nxitet të menduarit kritik tek studentët. Për dy vitet e fundit akademike (2022-2023; 2023-2024), 54% e personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit janë personel akademik efektiv ku të gjithë janë me grada/ tituj akademik. Zhvillimi i teknologjisë i ka sjellë më afër marrëdhënien pedagog student. Me ane metodave të mësimdhënies dhe të teknologjisë krijohet një marrëdhënie efektive dhe respekti ndërmjet pedagogëve dhe studentëve, gjë që u konfirmua edhe nga studentët gjatë vizitës në institucion. <i>Dok.61. Lista e stafit akademik të arsimuar dhe kualifikuar jashtë vendit;</i> <i>Dok. 116. 6.1 & 6.2 - Personeli Akademik për Programin e Studimit;</i> <i>Dok. 116. 7. Raporti i Personelit PAE/PAK sipas Titujve/Gradave;</i> <i>Dok. 116. 8. Personeli PAE/PAK sipas Titujve/Gradave dhe Moshës;</i>

Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Departamenti i Drejtësisë ka detyrimin që në çdo fillim viti akademik të përcaktojë ngarkesën mësimore dhe personelin e akademik të angazhuar në mësimdhënie, duke marrë parasysh kualifikimet dhe eksperiencën në fushën përkatëse. Studentët janë aktivë në dhënien e opinionit të tyre jo vetëm nëpërmjet diskutimeve por edhe nëpërmjet anketave që plotësojnë studentët ku japin vlerësimin dhe mendimin e tyre mbi lëndët dhe format e metodat e mësimdhënies. Departamenti vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike. Personeli akademik harton programin mësimor të lëndës, ai duhet ta plotësojë dhe përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme dhe ta dorëzojë atë në Departament, ku kjo e fundit është përgjegjëse për programin e studimit. Departamenti vlerëson programin e studimit, ku në përbërje të tij janë format e metodat e mësimdhënies. <i>Dok. 5. Rregullore e Njesisë Kryesore FDSHP;</i> <i>Dok.46. Raporti vjetor i NJSBC Viti Akademik 2022-2023;</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies	Institucioni e ka pjesë të strategjisë së tij përmirësimin në vijimësi të procesit akademik, përmes përfshirjes së të gjitha strukturave akademike, ndihmës-akademike dhe administrative. Shtyllat bazë të strategjisë së institucionit lidhen me procesin akademik në tërësi dhe kërkimor-shkëncor. Stafi akademik trajnohet në vijimësi për të përmirësuar metodat e mësimdhënies dhe për të përdorur metodat më innovative, në varësi të cdo programi studimi. Bashkëpunimi ndërmjet njësive është i përcaktuar në aktet bazë të institucionit. NJSBC në bashkëpunim me Departamentin e Drejtësisë monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të personelit akademik. NJSBC, angazhon edhe agjenci të jashtme të pavarura, siç është IQE, e cila jep përfundime të pavarura, cilësore dhe të besueshme. <i>Dok. 67. Vendim Senati Akademik për Komisionin dhe Promovimit të Personelit Akademik KUB;</i> <i>Dok. 59. 2.Format Pyetësori i Studentëve IQE;</i>

dhe zbatimit të metodave të reja.	Dok. 59. 3.Raporti i IQE për Stafin Akademik, 2021; Dok. 65. Vlerësim Performance stafi_TIP; Dok. 65. 1. Vlerësim Performance stafi personalizuar;			
Konkluzione	Institucioni harmonizon një seri formash të mësimdhënies dhe mësimxënies, falë ekperiencës së pedagogëve dhe punës që bëhet për trainimin dhe zbatimin e praktikave të përparuara për përmrësimin e punës së pedagogëve. KUB përmes njësive dhe zyrave përkatëse ofron për stafin akademik trajnime të vazhdueshme në lidhje me përdorimin dhe aplikimin e metodave interaktive dhe të dixhitalizuara të mësimdhënies, duke mundur për studentët një përfitimim sa më të mirë të njohurive në auditor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Rregullorja e KUB, Rregullorja e Fakultetit, Rregullorja e Departamentit të Drejtësisë dhe Rregullorja e Programit të Studimit, kanë të përcaktuara format e vlerësimit të njohurive të studentëve, sipas komponentëve të përcaktuara në syllabus-et e lëndëve. Këto komponentë të vlerësimit bëhen të njohura për studentët në cdo fillim semestri, nga stafi akademik përgjegjës për cdo lëndë. Gjithashtu, kriteret lidhur me procedurat e testimeve/vlerësimeve të studentëve janë pjesë përbërëse e rregullores për procedurat e provimeve në KUB të cilat zbatohen dhe ndiqen nga Sekretariteti e Fakulteteve. Dok. 5. Rregullore e Njesisë Kryesore FDSHP, neni 16; Dok. 6. Rregullore e Departamentit të Drejtësisë; Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit, neni 10;

	<i>Dok. 64. Rregullore për zhvillimin e provimeve, kreu IV, neni 10-13;</i>			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Syllabus-et e lëndëve publikohen online përpara fillimit të semestrit dhe studentët kanë mundësi të njihen me të gjithë komponentët e lëndës, duke përfshirë dhe format e kontrollit të njohurive dhe dijeve që do të përftohen përgjatë lëndës. Në platformën përkatëse të krijuar nga institucioni studentët kanë mundësi të aksesojnë informacionin e nevojshëm mbi përmbajtjen e lëndëve që do të ndjekin, dipas semestrit dhe vitit akademik që janë duke zhvilluar. <i>Dok. 116. 14 - Model Syllabus, elementët sipas VKM Nr. 41/2018;</i>			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Në përgatitjen e formave të testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentit harmonizohen karakteristikat e lëndës dhe zgjedhja që pedagogu konsideron si më të përshtatshmen për këtë qëllim, të cilat janë të përcaktuara në Planin e Lëndës. Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet në format tashmë të konsoliduar dhe përfshijnë elementë të vlerësimit të vazhdueshëm në seminar, testimin e ndërmjetëm, detyrat e kursit, provimin përfundimtar etj, elementë këto që u evidencuan të përcaktuara në syllabuse në kriteret standarde. <i>Dok. 107. Formular i vlerësimit të vazhduar TIP;</i> <i>Dok. 116. 15 - Format e Kontrollit të Njohurive;</i> <i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit, Neni 10;</i> <i>Dok.119. Urdhër për ngritjen e komisionit të provimit për mbrojtje diplome;</i>			
Konkluzione	<i>KUB harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive duke gërrshetur punën kërkimore gjatë kursit me provën përfundimtare. Zbatimi i këtyre procedurave të testimit të dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore garantohen si nga stafi akademik ashtu edhe ai ndihmës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në aktet e brendshme të KUB, përcaktohen qartë menyrat e vlerësimit të studentëve. Shkalla e përvetsimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin me dhjetë nota. Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë si më poshtë: Frekuentimi 10 pikë; Aktivizimi 10 pikë; Detyra/projekte 20 pikë; Provimi përfundimtar 60 pikë; Për sezonet e mëpasshme ato të riprovimeve studenti vlerësohet për atë që ka arritur të fitojë në testin e provimit. <i>Dok. 107. Formular i vlerësimit të vazhduar_TIP;</i> <i>Dok. 108. Procesverbal i provimit përfundimtar_TIP;</i> <i>Dok. 5. Rregullore e Njesisë Kryesore FDSHP;</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin formën e ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Pothuajse të gjitha vlerësimet e lëndëve të programit realizohen me shkrim në bazë të modelit të aprovuar të tezës së provimit. Tezat e provimit përgatiten nga pedagogu i lëndës përkatëse, dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit, të cilat kur shpërndahen në sallën e provimit bëhet vendosja e faqeve <i>cover</i> dhe sekretimi i tyre nga sekretaria mësimore. Komunikimi i pikëve dhe vlerësimi i vazhduar i komunikohet studentëve në auditor. <i>GVJ i sugjeron institucionit të vë sa më të shpejtë në përdorim sistemin elektronik të testimit dhe vlerësimit të provimeve, si një mjet për shmangien e abuzimit, dhe rritjen e transparencës.</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.asc.al

39

	<i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit, neni 10;</i> <i>Dok. 64. Rregullore për Zhvillimin e Provimeve, kreu IV, nenet 10-13;</i> <i>Dok.66. Rregullore e Sekretarisë Mësimore, kreu I;</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi Përfundimtar është parashikuar në një sërë aktesh rregullative si, Statut, Rregulloren e KUB, Rregulloren e Programit, Rregulloren e Provimeve, dhe Rregulloren e Sekretarisë Mësimore. Vlerësimi i studentit bëhet në përputhje me syllabusin e lëndës ku ka të parashikuar në një rubrikë “<i>Vlerësimi i Studentit</i>” në të cilin përcaktohet mënyra e vlerësimit përfundimtar me raportin 40/60 pikë. <i>Dok. 116. 14 - Model Syllabus, elementët sipas VKM Nr. 41/2018;</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Zhvillimi i testimit të vlerësimit bazohet në anonimitetin dhe monitorim nga Departamenti. Kushtet e zhvillimit të provimit janë optimale dhe hapësirat ndërmjet studentëve në këtë proces janë të përshtatshme. Format i tezes se provimit ka si seksion me vete komentet e pedagogut për përgjigjet e studentit për pyetjet që kërkojnë qëndrim/opinion të studentit. Në fund të tezes është vlerësimi i detajuar sipas pyetjeve teorike dhe ushtrimeve. <i>Dok. 108. Procesverbal i provimit përfundimtar TIP;</i> <i>Dok.64. Rregullore për zhvillimin e provimeve në KUB, neni 11;</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Bazuar në kuadrin e brendshëm rregullator si dhe nga takimi me stafin akademik dhe studentet e programit evidentohet korrektësia e zhvillimit të provimit si me monitorimin nga dy pedagoge, ashtu edhe moslejimi i përdorimit të celularëve apo formave të tjera të kopjimit. Për përgatitjen e temave të diplomave zbatohet udhëzuesi për punimin e diplomës, me të gjitha kriteret dhe standartet e caktuara nga KUB në rregullore. <i>Link 60: https://www.grammarly.com > plagiarism-checker;</i> <i>Link 61: https://plagiarismdetector.net;</i>

	<i>Dok.64. Rregullore për zhvillimin e provimeve në KUB, neni 14-15;</i> <i>Dok. 120. Paketë udhëzuese për mbrojtjen e diplomës me temë;</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Bazuar në dokumentacionin përkatës por edhe gjate takimeve me stafin akademik dhe studentet evidentohet se vlerësimi i dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën, ku pedagogu krahas realizimit të sekretimit të tezave shpall rezultatet e vlerësimit brenda kohës se parashikuar sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. Rezultatet e provimit hidhen në portal nga sekretaria e fakultetit jo më vonë se një javë nga data e zhvillimit të provimit. Studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij ose të ankimojë rezultatin brenda 3 ditëve nga data e komunikimit të rezultatit. <i>Dok. 5. Rregullore e Njesisë Kryesore FDSHP, neni 47;</i> <i>Dok. 4. Rregullore e KUB, kreu XI;</i> <i>Dok. 64. Rregullore për zhvillimin e provimeve në KUB, neni 16-17;</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Bazuar në rregulloret përkatëse të studimit studenti ka 3 dite kohe pas shpalljes se rezultatit të vlerësimit që të beje ankese nëse ai ka pretendime për një vlerësim me të larte. Institucioni ka të parashikuar në <i>nenin 98</i> të rregullores së KUB, të gjithë procesin e ankimimit të rezultatit të provimeve. Studentit i jepet mundësia të ballafaqohet me pedagogun e lendes dhe vlerësimin e bere si dhe i jepet përgjigja edhe e shkruar në formular. <i>Dok 64. Rregullore për zhvillimin e provimeve, neni 16, pika 3-4;</i> <i>Dok. 4. Rregullore e KUB, kreu XII, nenet 94-96-98;</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Referuar RVB studenti ka të drejtë të ankohet për çdo vlerësim të bërë. Ankimimi bëhet në sekretari brenda 3 ditëve nga marrja e rrezultatit të provimit. Rastet e kontestimit të vlerësimit nga studenti i dergohen sekretarisë, e cila njofton pedagogun. Pedagogu përkatës i rishqyrton kërkesat dhe në prani të studentit, në përfundim i komunikon sekretarisë qëndrimin dhe vlerësimin për ankimimin duke u shprehur për rezultatin.

	<i>Dok 64. Rregullore për zhvillimin e provimeve, neni 16, pika 3-6;</i> <i>Dok. 4. Rregullore e KUB, kreu XII, nenet 94, 96-98;</i>			
Konkluzione	<i>Procedurat e vlerësimit janë të drejta dhe bëhen transparente që në fillim të vitit akademik si nepermjet syllabuseve ashtu edhe sqarimit që bëhet përpara cdo testimi nga ana e pedagogut. Vlerësimi bazohet në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit, i cili sigurohet nga legjislacioni i institucionit.</i> <i>GVJ i sugjeron institucionit të vë sa më të shpejtë në përdorim sistemin elektronik të testimit dhe vlerësimit të provimeve, si një mjet për shmangien e abuzimit, dhe rritjen e transparencës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit i ofron studentëve njohuri si të zhvillojnë aftësitë kritike në disiplinat e ndryshme brenda programit të studimit. Bashkëpunimi me studentët në aktivitete shkencore, pjesëmarrja në gjyqe imituese apo klube studentore ku diskutohen publikisht çështje të së drejtës civile dhe tregtare jo vetëm thellon njohuritë por i mundëson atyre aftësim në publik. Azhornimi i vazhdueshëm i lëndëve me literaturën bashkëkohore por edhe thellimi i kërkimit shkecor individual nga ana e pedagogëve kontribuojnë në këtë drejtim. <i>Dok. 2.2. Plani Strategjik i zhvillimit të programit të studimit;</i> <i>Dok. 44. Studim Tregu për programin e studimit;</i> <i>Dok. 32. 2. Kurrikula e programit të studimit;</i> <i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit;</i>

	<i>Dok. 6. Rregullore e Departamentit të Drejtësisë;</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit parashikon një harmonizim të njohurive specifike të fushës me ato të teknologjisë së informacionit. Transmetimi i njohurive tek studentët kryhet duke përfshirë si njohuri metodologjike ashtu edhe punën konkrete nëpërmjet projekteve individuale ose në grup për të mbështetur zhvillimin e soft-skills apo detyrave të kursit për të nxitur zhvillimin e mendimit kritik të studentëve. Për të arritur një nivel të lartë kërkimi ashtu edhe për prezantimin e punës së kryer, studentët mbështeten tek teknologjia e informacionit (e-library apo format e ndryshme të prezantimit). <i>Dok. 32. 2. Kurrikula e programit të studimit;</i> <i>Dok. 44. Studim Tregu programi i studimit Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare";</i> <i>Dok. 2.2. Plani Strategjik i zhvillimit të programit të studimit;</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Stafi akademik prezanton për studentët planin e lëndëve, i cili shpjegon objektivat mësimore, dhe shpjegon të gjitha njohuritë dhe aftësitë që zhvillon studenti gjatë vitit akademik së bashku me aftësitë ndërvepruese të përmendura më lart si per shembull soft-skills apo në teknologjitë e informacionit, analizohen nga pedagogu në përfundimin e lëndës apo te semestrit. Ne takimin me studentet, GVJ vërejt se kjo analizë e njohurive që duhet të përfitohen por edhe asaj që mbetet ende për tu bërë ndihmon studentët për ti adresuar këto objektiva por edhe sugjerimet e pedagogëve në vijim të studimit akademik. Kjo praktikë u konfirmua edhe në takimin me pedagogët të cilët theksuan se kanë takime të vazhdueshme me studentët dhe në këto konsultime ofrohen sugjerimet përkatëse për përmirësimin e punës me studentët. <i>Dok. 32. Syllabus-et e Lëndëve/Moduleve të programit të studimit;</i> <i>Dok. 116. 14 - Model Syllabus, elementët sipas VKM Nr. 41/2018;</i> <i>Dok. 5. Rregullore e Njesisë Kryesore FDSHP;</i> <i>Dok. 31. Raporti vjetor i veprimtarive Departamenti i</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

43

	<i>Drejtësisë;</i> <i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit;</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikant profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Mësimdhënia zhvillohet duke u bazuar në kompetencat që synon të arrijë programi duke u bazuar në dy metodologji kryesore: teorike dhe praktike. Në aspektin teorik studentët përfitojnë nga leksionet, materiali shtesë, literatura e rekomanduar, si edhe informacioni i aksesueshëm. Kjo realizohet falë infrastrukturës në aspektin teorik sic është libraria online, biblioteka apo edhe aksesit që kanë studentët në programe të ndryshme të literaturës. Ndërkohë institucioni vë në dispozicion të studentëve të programit infrastrukturën e nevojshme për të realizuar në aspektin praktik aktivitete të ndryshme sic janë hulumtimet, diskutimet në grupe ku studentët paraqesin pikpamjet e tyre lidhur me temën që trajtohet dhe interpretimin e tyre mbi njohuritë e marra. Pedagogu sigurohet që diskutimi të jetë gjithëpërfshirës dhe sa më shumë studentë të marrin pjesë. <i>Dok. 102. Relacion për Konferencat Kombëtare dhe Ndërkombëtare;</i> <i>Link 62 Konferenca Shkencore: https://kub.edu.al/kerkimi-shkencor/;</i> <i>Dok. 116. Tabelat Përmbledhëse Aneks RVB Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare" Tab.1-10;</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik është i organizuar në vazhdimësi në veprimtari shkencore jashtë programit të studimit dhe për këtë qëllim organizon orë të hapura por edhe inkurajon studentët që të marrin pjesë në seminarët akademike të organizuara nga KUB apo institucione të tjera duke paraqitur edhe punimet e përgatitura nga studentët në bashkëpunim edhe me pedagogoet Një trajnim i rëndësishëm i zhvilluar për personelin akademik dhe ndihmës ka qenë trajnimi mbi website dhe mënyrën e përdorimit të portalit të KUB, ku pas përfundimit të tij u shpërnda edhe Udhëzimi i Përdorimit. <i>Link 63: https://kub.edu.al/events/leksion-i-hapur-mbajtur-nga-avokat-spartak-ngjela-me-teme-reforma-ne-drejtesi-dhe-</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

44

	<i>efektet-e-saj-ne-sistemin-politik-dhe-ekonomik-ne-mjediset-e-kub/;</i> <i>Link 64: https://kub.edu.al/lajme/leksion-i-hapur-nga-z-besnik-dervishi/;</i> <i>Dok. 88. Lista e personaliteteve të ftuar për Leksione të Hapura KUB;</i> <i>Dok. 52. Udhëzues institucional për zhvillimin dhe përdorimin e "GOOGLE APPS";</i>			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Pedagogët promovojnë pjesmarrjen e studentëve në aktivitetet shkencore ku ata mund të marrin pjesë me prezantime për të inkurajuar më tej idetë e tyre inovative duke i ofruar edhe mundësinë e financimit të pjesmarrjes në këto aktivitete. Realizimi i konferencave studentore gjithashtu krijon më shumë hapësira për diskutimin e punimeve të ndryshme si dhe ju mundëson studentëve paraqitje të punimit të tyre në një prezantim të përmbledhur duke shprehur risitë dhe idetë e reja që ata sjellin. <i>Dok. 33. Program i Konferencës Shkencore Studentore;</i> <i>Dok. 81. Proceedings i Konferencës së IX-të Shkencore Ndërkombëtare;</i> <i>Link 65: https://kub.edu.al/events/konferenca-e-v-te-nderkombetare-shkencore-studentore-ne-kolegjin-universitar-te-biznesit/;</i> <i>Link 66: https://kub.edu.al/lajme/ditet-e-erasmus-ne-kub/;</i>			
Konkluzione	<i>Programi përgjithësisht garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët që synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek ta në të ardhmen.</i> <i>Pjesmarrja e studentëve si në aktivitetet akademike ashtu edhe në ato kërkimore synon zhvillimin e thelluar të kompetencave të tyre profesionale dhe shkencore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Plani mësimor dhe rregullorja e departamentit (<i>nenet 31, 32</i>) përcaktojnë procedurat që duhet të ndjekin studentët lidhur me detyrimet përmbyllëse dhe përgatitjen për mbrojtjen e mikrotezës. Përsa i takon programit të masterit i shkencave, në “E Drejtë Civile dhe Tregtare”, studentët duhet që fillimisht të përmbyllin të gjitha detyrimet për çdo modul të programit dhe më pas mund të fillojnë punimin përfundimtar për diplomimin, informacion i cili është i aksesueshëm online dhe bëhet në konsultim me pedagogun. Studentët duhet të zbatojnë udhëzimin / rregulloren e miratuar nga Senati Akademik mbi përgatitjen e temave. Departamenti propozon emrat e pedagogëve udhëheqës, kur vetë studenti nuk e ka siguruar një pedagog udhëheqës duke u bazuar në fushën që ka përzgjedhur studenti. <i>Dok. 120. Paketë udhëzuese për mbrojtjen e diplomës me temë;</i> <i>Dok.119 Urdhër për ngritjen e komisionit të provimit për mbrojtje diplome;</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Cdo pedagog i caktuar si udhëheqës i tezës punon me studentin duke e udhëzuar për forminin e argumentit shkencor dhe materialet që duhet të konsultojë studenti. Pedagogët por edhe sekretaria mësimore i ndihmojnë studentët me informacionin e nevojshëm lidhur me detyrimet afatet kohore dhe procedurat e realizimit të detyrimeve përmbyllëse. Ky informacion përfshin si detyrimet akademike ashtu edhe ato financiare që studentët kanë për përmbylljen e programit. Gjithashtu në rrjetet sociale, shpallen datat e provimeve sipas sezoneve përkatëse. <i>Dok. 120. Paketë udhëzuese për mbrojtjen e diplomës;</i> <i>Dok. 71. Urdhër Rektori për zhvillimin e provimeve;</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në	Programi nuk organizon një provim përfundimtar për të testuar njohuritë e studentëve në përfundim të programit por një punim

testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	përfundimtar të diplomës. Ngrihet një komision prej tre anëtarësh të propozuar nga Departamenti dhe miratuar nga dekani. Mbrojtja kryhet me prezantim me gojë përpara komisionit. Mbrojtja e diplomës vlerësohet me notë dhe me kredite sipas planit mësimor. <i>Dok. 120. Paketë udhëzuese për mbrojtjen e diplomës;</i> <i>Dok. 6. Rregullore e Departamentit të Drejtësisë;</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Studentët mund të zgjedhin ndërmjet stafit akademik të programit udhëheqësin për dizertacionin duke patur parasysh përputhshmërinë e fushës së kompetencave akademike të pedagogut me temën e dizertacionit që ata mendojnë. KUB ka hartuar dok “<i>Dok. 118. Paketë udhëzuese për mbrojtjen e diplomës me temë</i>” ku janë parashikuar të gjitha detyrimet e udhëheqësit, kërkesat kryesore në hartimin dhe paraqitjen e materialit, struktura e punimit, përmbajtja e elementëve strukturor etj. Disa nga detyrimet e udhëheqësit janë: - të garantojë zbatimin e të gjitha rregullave të udhëheqjes së mikrotezës; - të sigurojë kryerjen e udhëheqjes brenda kohës së parashikuar; - të japë konsulencën e nevojshme që ti mundësojë kandidatit standarte të larta të kërkimit; - të monitorojë punën e studentit përkundrejt standartit të kërkuar; - të bëjë kritikën e duhura për punimin e studentit brenda kohës së caktuar; <i>Dok. 118. Paketë udhëzuese për mbrojtjen e diplomës me temë;</i> <i>Link 60: https://www.grammarly.com > plagiarism-checker] Link 61: https://plagiarismdetector.net]</i> <i>Dok.117 - Model Proces Verbal Vlerësimi Provim Diplome;</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve,	KUB angazhohet për të lehtësuar procesin e diplomimit të studentëve duke garantuar seancat orientuese dhe këshilluese nga ana e personelit akademik udhëheqës. Studentit i jepet mundësia




analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	të punojë në laboratorët e informatikës, bibliotekën online, zhvillimin e praktikave të nevojshme, udhëzimet për zhvillimin e praktikave profesionale, udhëzimeve për zhvillimin e sezoneve të provimeve etj. <i>Dok. 116.17. Të dhëna për Platformat Online/Struktura e IT/Biblioteka online</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Punimi i diplomës vlerësohet nga komisioni prej tre anëtarësh i ngritur dhe aprovuar për këtë qëllim nga Dekanati, duke patur parasysh cilësinë shkencore të punimit, si edhe duke i ofruar studentit feedback lidhur me aspektet pozitive ashtu dhe pikat që meritonin më shumë vemendje. Mbrojtja kryhet me prezantim me gojë përpara komisionit. Mbrojtja e diplomës vlerësohet me notë dhe me kredite sipas planit mësimor. Temat e Diplomës ruhen në sekretarinë mësimore dhe në arkivin e KUB. <i>Dok.4 Rregullore e KUB, kreu XIV, neni 105;</i> <i>Dok. 6. Rregullore e Departamentit të Drejtësisë;</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	KUB në aktet rregullatore të tij, (<i>rregullore e Njësisë Kryesore FDSHP, keru IX; Rregullore e Programit të Studimit etj</i>) ofron udhëzime të qarta për pajisjen e studentit me diplomën e Masterit. Në përfundimin e suksesshëm të programit të gjithë studentët pajisen me diplomën e Masterit Shkencor dhe me suplementin e diplomes. Forma dhe përmbajtja e këtyre dokumentave janë të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Qendra Kombëtare e Shërbimit të Studentëve (QSHA), dhe rregjistrohen pranë Zyrës së Rregjistrimit, ndërsa dorëzimi i tyre bëhet në një ceremoni të vecantë. <i>Dok. 5. Rregullore e Njësisë Kryesore FDSHP, keru IX;</i> <i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit;</i> <i>Dok. 32. 9. Model Diplome;</i> <i>Dok. 32. 10. Diploma Suplement;</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me	Sekretaria Mësimore ka si detyrë mbajtjen e rregjistrimit themeltar me të dhënat e studentëve, si në formën fizike ashtu edhe në atë

legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	elektronike. Kjo Sekretari ngarkohet edhe me mbajtjen e dosjeve të studentëve ku pasqyrohen kreditet e akumuluar. Dosja individuale e studentit pasi diplomohet/ transferohet/ çrregjistrohet arkivohet duke i bashkangjitur edhe fotokopje të diplomës dhe suplementit në dosjen e tij. Dosjet personale të studentëve pas diplomimit ruhen në arkivin e KUB, duke respektuar normat në fuqi për privatësinë por edhe rregulloren e këtij arkivi. <i>Dok. 10. Rregullore e Zyrës së Arkivit;</i> <i>Dok. 66. Rregullore e Sekretarisë Mësimore;</i> <i>Dok. 32. Dosja e Programit të Studimit;</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ndjek një procedurë të qartë dhe transparente të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit. Ky hap ndërmerret vetëm pasi studenti ka shlyer të gjitha detyrimet akademike, ndërsa ndihmohet në të gjithë procesin nga udhëheqësi i tezës finale. KUB e përgatit studentin me dokumentacionin e nevojshëm duke përfshirë si diplomën ashtu edhe diploma suplement.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike,	N / A

praktikës profesionale.				
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	N / A			
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	N / A			
Konkluzione	GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Programi i studimit Msc në “E drejtë Civile dhe Tregtare” ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Politike. Sipas listave të personelit akademik për vitin akademik 2023-2024, rezultojnë se Departamenti i Drejtësisë, si departament përgjegjës për programin e studimit, ka në përbërje 7 personel akademik me kohë të plotë, nga të cilët 1 me titullin Prof.Asoc.Dr dhe 5 me gradën shkencore Dr., në përputhje me kërkesat e nenit 25, pika 4, të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si edhe 6 personel akademik me kohë të pjesshme. Sipas tabelave përmbledhëse personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Msc në “E drejtë Civile dhe Tregtare” ndër vite rezultojnë si më poshtë: - Viti akademik 2018-2019 ka 6 personel PAE, nga të cilët 1 Prof.As., 5 Dr, si dhe 4 personel PAK (2 Prof., 2 Dr.) - Viti akademik 2019-2020 ka 5 personel PAE, nga të cilët 1 Prof.As., 4 Dr, si dhe 4 personel PAK (1 Prof., 3 Dr.) - Viti akademik 2020-2021 ka 7 personel PAE, nga të cilët 1 Prof.As., 6 Dr, si dhe 3 personel PAK (1 Prof., 2 Dr.) - Viti akademik 2021-2022 ka 7 personel PAE, nga të cilët 2 Prof.As., 5 Dr, si dhe 6 personel PAK (1 Prof., 5 Dr.) - Viti akademik 2022-2023 ka 6 personel PAE, nga të cilët 2 Prof.As., 4 Dr, si dhe 5 personel PAK (1 Prof., 4 Dr.) - Viti akademik 2023-2024 ka 6 personel PAE, nga të cilët 2 Prof.As., 4 Dr, si dhe 5 personel PAK (1 Prof., 4 Dr.). Sa më sipër rezultojnë se i gjithë personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Msc është me tituj dhe grada dhe




	plotëson kërkesat e nenit 59, pika 6, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në të cilin përcaktohet se: <i>“Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës...”</i>. Referuar planit mësimor të lidhur me personelin akademik përkatës, si dhe referuar CV-ve të stafit të vëna në dispozicion, rezulton se niveli i kualifikimit akademik dhe fusha kërkimore e personelit është në përputhje me lëndët/modulet mësimore të programit të studimit ku janë angazhuar. <i>Dok. 116. Tabelat Përmbledhëse Aneks RVB Msc në “E drejtë Civile dhe Tregtare” Tab.1-10;</i>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Për 4 vitet e fundit akademike, mbulimi i ngarkesës mësimore të programit të studimit, nga stafi akademik efektiv, paraqitet si më poshtë (<i>Dok. 116. Tabelat Përmbledhëse Aneks RVB Msc në “E drejtë Civile dhe Tregtare” Tab .11-23</i>) - Për vitin akademik 2020- 2021, ngarkesa totale mësimore e programit, e mbuluar nga personeli akademik efektiv është 840 orë, 71%, ndërsa ngarkesa e mbuluar nga personeli akademik me kontratë është 332 orë, 29%; - Për vitin akademik 2021- 2022, ngarkesa totale mësimore e programit, e mbuluar nga personeli akademik efektiv është 788 orë, 70%, ndërsa ngarkesa e mbuluar nga personeli akademik me kontratë është 324 orë, 30%; - Për vitin akademik 2022-2023, ngarkesa totale mësimore e programit, e mbuluar nga personeli akademik efektiv është 788 orë, 66%, ndërsa ngarkesa e mbuluar nga personeli akademik me kontratë është 392 orë, 34%; - Për vitin akademik 2023-2024, ngarkesa totale mësimore e programit, e mbuluar nga personeli akademik efektiv është 780 orë, 66%, ndërsa ngarkesa e mbuluar nga personeli akademik me kontratë është 400 orë, 34%; Nga sa më sipër, rezulton që për 2 vitet e fundit akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, <i>nuk</i> është përballuar <u>mbi</u> 70% nga stafi akademik efektiv, sipas VKM Nr.




	418, datë 10.05.2017 ku citohet: “Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për cdo program studimi”, në përputhje me fushën e kualifikimit dhe fushën kërkimore të anëtarëve të stafit. <i>GVJ rekomandon që përballimi i ngarkesës mësimore të programit të studimit Master i Shkencave në “E Derjtë Civile dhe Tregtare” të realizohet në masën 70% nga staf akademik efektiv (PAE), në plotësim të standardit të kërkuar.</i> <i>Dok. 116. Tabelat Përmbledhëse Aneks RVB Msc në “E drejtë Civile dhe Tregtare” Tab .11-23.</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, si listat e personelit akademik për vitet 2018 e në vazhdim, CV-të e personelit, shqyrtimit të kontratave të punës të lidhura ndërmjet IAL-së dhe personelit dhe listëpagesave të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, rezulton se KUB garanton qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi. Për të përmbushur këtë qëllim, si dhe në zbatim të kërkesave të Ligjit për arsimin e lartë, institucioni lidh kontrata me afat të pacaktuar me lektorët e kategorisë Doktor dhe Profesor. <i>Dok. 84. Lista e Pedagogëve në KUB për Vitin Akademik 2022-2023;</i> <i>Dok. 83. Vendim Senatit Akademik mbi normën e stafit akademik bazuar në kualifikimin e tyre;</i> <i>Dok. 116. Tabelat Përmbledhëse Aneks RVB Msc në “E drejtë Civile dhe Tregtare” Tab .11-23.</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën,	Procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë të parashikuara në Statutin e KUB neni 44, Rregulloren e Përgjithshme neni 46, Rregulloren për Marrëdhëniet e Punës në KUB nenet 9-14. Referuar praktikave të rekrutimit të stafit të vëna në dispozicion, punësimi kryhet me procedurë konkurrimi të hapur publik dhe transparent, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike, sipas përcaktimeve të Ligjit për arsimin e lartë dhe akteve të brendshme rregullatore të IAL-së, duke garantuar përzgjedhjen e personelit me kualifikimin e

strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	duhur dhe në përputhje me programin e studimit. <i>Dok. 1. Statuti i KUB;</i> <i>Dok. 4. Rregullore e KUB;</i> <i>Dok. 12. Rregullore e Marrëdhënieve të Punës në KUB;</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Pjesë e programit të studimit janë edhe laboratorët e Informatikës, ku studentët e këtij programi kanë mundësinë të kryejnë detyrat e kursit, apo punë në grup. Programi në vetvete nuk ka pjesë të tij personel ndihmës akademik, por laboratori i Informatikës ka një personel ndihmës që siguron mirëmbajtjen e pajisjeve dhe mjediseve mësimore.
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Zyra e Burimeve Njerëzore në KUB, ruan dhe administron çdo vit akademik të dhënat dhe dokumentacionin e personelit të angazhuar në programin e studimit, duke përfshirë personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, personelin ndihmës akademik dhe atë administrativ. Dosjet e personelit përditësohen në mënyrë të vazhdueshme me dokumentacionin përkatës, ashtu si edhe CV-të e personelit, të cilat gjenden edhe në website. <i>Dok. 84. Lista e Pedagogëve në KUB për Vitin Akademik 2022-2023;</i> <i>Dok. 83. Vendim Senatit Akademik mbi normën e stafit akademik bazuar në kualifikimin e tyre;</i> <i>Dok. 116. Tabelat Përmbledhëse Aneks RVB Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare" Tab .11-23.</i> <i>Dok. 86. Përmbajtja dokumentare e dosjes së stafit FT;</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e	Për ndjekjen dhe udhëheqjen e praktikave profesionale të studentëve në IAL të tjera apo biznese, në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura për këtë qëllim, KUB cakton personel akademik të kualifikuar me përvojë. Gjithashtu KUB fton për leksione të hapura apo udhëheqje diplome të studentëve, personalitete të fushës nga biznesi, administrata

mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	publike, institucionet e pavarura kushtetuese etj. <i>Dok. 88. Lista e personaliteteve të ftuar për Leksione të Hapura KUB;</i> <i>Dok. 27. 2. Marrëveshje bashkëpunimi TIP për Praktikën Profesionale;</i>			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve, përfaqësuesit e biznesit pritës kanë mbështetur studentët për përmbushjen e praktikës në kohë dhe me cilësi. Në përfundim të praktikës ata hartojnë një raport vlerësimi mbi kryerjen e praktikës profesionale duke vlerësuar angazhimin dhe punën e kryer nga studenti gjatë praktikës profesionale. Ky raport është pjesë e vlerësimit përfundimtar nga Komisioni i Mbrojtjes së Praktikës, pjesë e të cilit është edhe pedagogu që ka ndjekur dhe monitoruar praktikën e studentit. Gjithë kjo procedurë është pjesë e dokumentit Udhëzues për përgatitjen e praktikës profesionale, si dhe u konfirmuar nga takimi me studentët e IAL-së. <i>Dok. 27. Udhëzues për Përgatitjen Praktikës Profesionale;</i> <i>Dok. 27. 2. Marrëveshje bashkëpunimi TIP për Praktikën Profesionale;</i>			
Konkluzione	<i>Njësia kryesore dhe ajo bazë përgjegjëse për programin e studimit kanë sasinë e nevojshme të stafit akademik i cili ka formimin e përshtatshëm dhe kualifikimin e kërkuar nga ligji.</i> <i>U konstatua se personeli akademik efektiv nuk e mbulon 70% të ngarkesës mësimore gjatë dy viteve akademike, ndaj <u>GVJ rekomandon</u> që përballimi i ngarkesës mësimore të programit të studimit Master i Shkencave në “E Derjtë Civile dhe tregtare” të realizohet në masën 70% nga staf akademik efektiv (PAE), në plotësim të standardit të kërkuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

			X	
--	--	--	---	--

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	KUB e zhvillon veprimtarinë e tij akademike në godinën kryesore 4 kate me adresë rruga "Gjergj Legisi", nr. 23, Laprakë, Tiranë, me sipërfaqe totale 1950 m ² . Nga vizita në institucion, rezulton se godina ka të gjitha mjediset e nevojshme, sipas përcaktimeve të VKM nr. 418, datë 10.05.2017, në funksion të realizimit të procesit mësimor akademik, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe është i organizuar në auditorë për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve, mjedise për personelin akademik dhe atë administrativ, biblioteka, mjediset laboratorike dhe të zhvillimit të praktikave profesionale, ambiente teknike dhe ndihmëse, oborr dhe ambiente të gjelbëruara etj. <i>Dok. 80. Relacion mbi infrastrukturën e KUB;</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizitës në institucion, u konstatua se të gjitha mjediset mësimore si auditorët dhe klasat e seminareve, laboratorët dhe ambientet e personelit janë të pajisura me mjetet teknologjike, kompjuter, videoprojektor, me akses të palimituar në internet, që shërbejnë për realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, nëpërmjet metodave teknologjike bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies. <i>Dok. 80. Relacion mbi infrastrukturën e KUB;</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë	Për shkak të natyrës dhe përmbajtjes së programit të studimit, në funksion të realizimit të tij, janë 2 laboratorë të Informatikës me kapacitet të mjaftueshëm për plotësimin e nevojave për përmbushjen e programit. Këta laboratorë shfrytëzohen nga

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

56

aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimi teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	studentët e programit jo vetëm për detyra kursi, punë në grup, por edhe për realizimin e lëndës SMI, pjesë e programit Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare". Ndërkohë, në funksion të programeve të tjera, sipas natyrës dhe specifikës së tyre, IAL ka në dispozicion Laboratorin e Mekanikës, Elektrik dhe Elektronikës, të pajisura me mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimi teorik e praktik. <i>Dok. 80. Relacion mbi infrastrukturën e KUB;</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Në funksion të procesit akademik, IAL ka në dispozicion laboratorin e Informatikës me kapacitet 50 PC me akses të pakufizuar në internet, me programe/softe aplikative të instaluar, sipas nevojave të programeve të studimit. <i>Dok. 80. Relacion mbi infrastrukturën e KUB;</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	Institucioni ka marrë masat që të garantojë kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e praktikave profesionale. KUB ka lidhur një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me institucione, organizata zyra avokatie dhe noterie, si dhe me biznesin për realizimin e praktikave profesionale të studentëve të programit. Sipas përcaktimeve të marrëveshjeve specifike, këto organizma vejnë në dispozicion të studentëve mjediset dhe infrastrukturën e përshtatshme për të kryer praktikën profesionale. <i>Dok. 27. 2. Marrëveshje bashkëpunimi TIP për Praktikant Profesional;</i> <i>Dok. 27. Udhëzues për Përgatitjen Praktikës Profesionale;</i>
Konkluzione	<i>KUB ka në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të</i>

	<i>programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit, duke përfshirë ambientet e detyrueshme akademike, administrative dhe ndihmëse, si dhe mjetet e nevojshme teknologjike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë dhe ajo e rekomanduar si ndihmëse për programin e studimit Msc. “E drejtë Civile dhe Tregtare”, janë përcaktuar në syllabuset e lëndëve. Literatura bazë që ofrohet në këtë program studimi është në gjuhën shqipe, sipas gjuhës së programit. Në rast se moduli nuk ka një tekst të botuar në gjuhën shqipe, personeli akademik angazhohet në përgatitjen e cikleve të leksioneve, të cilat i vihen në dispozicion studentëve nëpërmjet librarisë së KUB. E gjithë literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion si fizike ashtu edhe digjitale, garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme në funksion të realizimit të programit të studimit. <i>Dok.32.4. Syllabus-et e LëndëveModuleve të programit të studimit;</i> <i>Dok .32.7.Rifreskim i literaturës. Model Syllabusi;</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.	Në çdo vit akademik, pedagogët e lëndës hartojnë nevojat për përditësimin e literaturës me botime të reja, të cilat i paraqiten departamentit dhe mundësohet blerja e tyre, me qëllim pasurimin e bibliotekës me literaturën e nevojshme dhe të përditësuar. KUB ka në dispozicion edhe listën e teksteve të reja pjesë të programit të studimit Msc. “E drejtë Civile dhe Tregtare”.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

58

	<i>Dok. 48. Lista e tekseteve të reja për programin e studimit Msc në E drejtë Civile dhe Tregtare;</i> <i>Dok. 58. Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022;</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	IAL ka në dispozicion bibliotekën, në funksion të relizimit të procesit akademik dhe përmbushjes së programit të studimit Msc. “E drejtë Civile dhe Tregtare”. Biblioteka ofron akses të barabartë pa pagesë për të gjithë studentët, si edhe për personelin akademik dhe atë administrativ. <i>Dok. 48. Lista e tekseteve të reja për programin e studimit Msc në E drejtë Civile dhe Tregtare;</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka e KUB është e organizuar në dy mjedise, me një sipërfaqe prej afërsisht 70 m², me kapacitet 50 vende dhe e pajisur me kompjuter Laptop me akses në internet. Biblioteka disponon rreth 7000 libra/ekzemplarë në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, të cilat janë në funksion të realizimit të programeve të studimit. Fondi i bibliotekës pasurohet vazhdimisht me literaturë të re të përditësuar, nëpërmjet blerjeve me fondet e planifikuara nga IAL, si dhe dhurimeve nga donatorët. Pjesë e fondit të bibliotekës janë edhe revistat periodike shkencore dhe të botimeve <i>Proceedings</i> të Konferencave shkencore të zhvilluara çdo vit nga KUB. <i>Dok. 90. Marrëveshje bashkëpunimi JSTORE-biblioteka;</i> <i>Dok. 91. Relacion i bibliotekës së KUB;</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Nëpërmjet marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar nga IAL, studentët dhe personeli akademik i KUB ka akses në bibliotekë online të JSTOR. Kjo bibliotekë online është një mundësi e mirë për t’u njohur dhe për të aksesuar literaturën më bashkëkohore në fushat që lidhen me programin e studimit “E drejtë Civile dhe Tregtare”. Personeli e akseson këtë bibliotekë online direkt nga zyrat e tyre, ndërsa studentët e aksesojnë pa pagesë nga Biblioteka e KUB. <i>Dok. 90. Marrëveshje bashkëpunimi JSTORE-biblioteka;</i> <i>Dok. 91. Relacion i bibliotekës së KUB;</i>

Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka e KUB është e pajisur me kompjutera, ku studentët mund të aksesojnë pa limit në internet dhe të ndërlidhen me bibliotekat online. Biblioteka është e pajisur me një sistem dokumentacioni dhe informacioni, i cili krijon mundësi për shkëmbimin e të dhënave me Bibliotekën Kombëtare, bibliotekat europiane, si dhe partneritetin me institucione brenda dhe jashtë vendit për abonime online. <i>Dok. 92. Rregullore e Bibliotekës;</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka funksionon sipas një rregulloreje të miratuar me vendim të Senatit Akademik. Për t'u shërbyer sa më shumë studentëve dhe personelit akademik, biblioteka ofron shërbim në ditët nga e hëna në të shtunë, në oraret 09:00-15:00 dhe 16:00-20:00. Biblioteka administrohet nga një personel i caktuar si përgjegjës i saj. Orari i funksionimit të bibliotekës gjendet i publikuar edhe në web-in zyrtar të KUB. <i>Dok. 92. Rregullore e Bibliotekës;</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e	Rregullorja e Bibliotekës ka parashikuar detyrat dhe përgjegjësitë e personit përgjegjës të caktuar për cilësinë e ruajtjes, shfrytëzimit të fondit fizik dhe online, frekuentimit nga personeli dhe studentët, si dhe rifreskimit të vazhdueshëm të titujve të bibliotekës, sipas nevojave dhe kërkesave akademike të programeve të studimit që ofrohen në KUB. Personi përgjegjës i bibliotekës informon në vazhdimësi drejtuesit e institucionit lidhur me listën e hyrjeve të reja, listën e abonimeve vjetore, duke propozuar dhe marrjen e masave për përmirësimin e cilësisë së fondit të librave sipas programeve të studimit. I gjithë fondi i bibliotekës është i informatizuar. <i>Dok. 92. Rregullore e Bibliotekës;</i>

personelit akademik.				
Konkluzione	<i>E gjithë literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion si fizike ashtu edhe digjitale, është e përditësuar dhe garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme në funksion të realizimit të programit të studimit. IAL ofron akses të palimituar për studentët dhe personelin si në bibliotekën fizike që ndodhet në mjediset e tij ashtu edhe në bibliotekat online me të cilat ka lidhur marrëveshje.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Në IAL KUB është ngritur dhe funksionon prej vitesh një sistem i konsoliduar i menaxhimit të informacionit institucional, sistem i cili administron të gjithë informacionin në lidhje me studentët, duke nisur nga dita e parë e prezantimit të tyre me institucionin. Sistemi i menaxhimit institucional ka të integruar platformën e Portalit të KUB (https://portal.kub.edu.al/hyrje/), e cila mundëson komunikim interaktiv dhe shkëmbim të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. Platforma institucionale e menaxhimit të informacionit, Portali i KUB aksesohet nëpërmjet një account-i personal nga çdo personel akademik dhe student i KUB (logimi për studentët emër.mbiemër@kub.edu.al; për stafin xmbiemër@kub.edu.al). Informacioni i aktivitetit të studentëve nga regjistrimi e deri në diplomimin e tyre menaxhohet nga strukturat përkatëse të krijuara me aktet e brendshme rregullatorë të IAL-së si Statut, rregullore etj. Njësia kryesore përgjegjëse për shërbimet ndaj studentëve është sekretaria mësimore, e cila ka rregulloren e saj për funksionimin.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

61

Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Platforma institucionale e menaxhimit të informacionit, Portali i KUB aksesohet nëpërmjet një account-i personal nga çdo personel akademik dhe student i KUB. Të gjitha të dhënat dhe dokumentacioni i personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ, administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore në KUB. Dosjet e personelit përmbajnë dokumentacion të plotë si: CV, diploma, certifikata trajnimi/kualifikimi, kontratë pune, kopje ID etj. <i>Evidenca nr 1 "Statuti i KUB"</i> <i>Evidenca nr.4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 31 "Raport vjetori i veprimtarive Departamenti i Drejtësisë, viti akademik 2022-2023"</i> <i>Evidenca nr 40 "Paketa e regjistrimit të studentit"</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	KUB ka krijuar website-n, ku në domain-in e tij secili pedagog menaxhon account-in e tij personal, nëpërmjet të cilit komunikon me studentët. Studentët kanë akses në materialet akademike të modulit apo lëndës, detyrimet që bartin, leksione të përmbledhur, detyra kursi etj, materiale të cilat jepen nga pedagogu. https://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale/ https://kub.portali.kub.edu.al/hyrje
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Siç edhe është cituar më sipër, sistemi i menaxhimit institucional ka të integruar platformën e portalit të KUB, e cila mundëson komunikim interaktiv dhe shkëmbim të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. Ndërkohë, gjatë periudhës së pandemisë, për realizimin e mësimdhënies online, janë përdorur platformat Google classroom, Zoom-meet. Personeli akademik menaxhon një llogari individuale dhe një link për çdo modul të zhvilluar, i cili shërben si një mjet efikas komunikimi ndërmjet pedagogëve, studentëve dhe administratës. https://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale/ https://kub.portali.kub.edu.al/hyrje
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton	Sistemi i menaxhimit institucional (Portali i KUB) mundëson që personeli akademik i KUB të raportojë në kohë reale lidhur me




monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	aktivitetin akademik dhe procesin mësimor, duke garantuar në këtë mënyrë monitorimin nga organet dhe autoritetet drejtuese. <i>Evidenca nr.4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 31 "Raport vjetor i veprimtarive Departamenti i Drejtësisë, viti akademik 2022-2023"</i> https://kub.portali.kub.edu.al/hyrje			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	KUB disponon faqen e tij zyrtare https://kub.edu.al e cila është ndërtuar dhe funksionon me kërkim në dy gjuhë, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Ky website ofron informacion të plotë rreth kolegjit, programeve të studimit, kurrikulën për çdo program, syllabuset.			
Konkluzione	Sistemi i menaxhimit institucional ka të integruar platformën e Portalit të KUB (https://portal.kub.edu.al/hyrje/), e cila mundëson komunikim interaktiv dhe shkëmbim të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. Portali i KUB aksesohet nëpërmjet një account-i personal nga çdo personel akademik dhe student i KUB.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për	Çdo vit KUB harton Raportin Financiar vjetor të institucionit, i cili ndër të tjera përmban kostot e programit të studimit, të miratuar me vendim të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. Gjithashtu, në Pasqyrat Financiare Vjetore, paraqiten në mënyrë të detajuar kostot sipas zërave kryesore të shpenzimeve për njësinë bazë, përgjegjëse për programin e

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

63

mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	studimit. Mbi këtë bazë, treguesit kryesorë bëhen pjesë e Raportit Vjetor "Mbi veprimtarinë akademike dhe financiare" të KUB, i cili bëhet publik, dhe përmban edhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit. <i>Evidenca nr 1 "Statuti i KUB"</i> <i>Evidenca nr.4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 5 "Rregullore e Njësië Kryesore FDSHP"</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Institucioni harton çdo vit Planin Buxhetor Vjetor dhe atë afatmesëm (3-vjeçar). Plani financiar parashikon të ardhurat që krijohen kryesisht nga tarifat vjetore të studimeve, nga shërbimet ndaj studentëve, aktivitete, konferenca, projekte. Plani i financimit strukturohet në nivel institucioni, njësië kryesore dhe njësië bazë dhe përmban financimin e burimeve njerëzore në funksion të realizimit të programit të studimit, shpenzimet për mirëmbajtjen e mjediseve, për sigurimin e teknologjive mbështetëse, bibliotekën fizike dhe online etj. <i>Evidenca nr. 47 "Relacion për Realizimin e Buxhetit 2002 dhe planifikimi 2023 KUB"</i> <i>Evidenca nr 57 "Vendim i BA për mbështetjen financiare për kërkimin shkencor të stafit akademik KUB"</i> <i>Evidenca nr 58 "Raport Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022"</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Në KUB është ngritur Zyra e Programimit dhe Raportimit Financiar, e cila funksionon nëpërmjet një Programi të Informatizuar Kontabiliteti, duke zbatuar rregullat për dokumentimin dhe plotësimin e kërkesave ligjore. Institucioni realizon në mënyrë periodike auditime të brendshme financiare, nëpërmjet personave të specializuar. Ndërkohë që auditimi i jashtëm financiar kryhet nga një kompani ndërkombëtare auditimi "Grant Thornton". Gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, paraqiten për diskutim

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

64




	dhe vendimmarrje në organet drejtuese të KUB, në Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit, ndërsa vendimet publikohen në web. <i>Evidenca nr. 47 "Relacion për Realizimin e Buxhetit 2002 dhe planifikimi 2023 KUB"</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Në fund të çdo viti akademik, drejtuesit e institucionit, mbi bazën e raportit vjetor të realizimit të buxhetit të miratuar, raportojnë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit, mbi realizimin e buxhetit sipas zërave, duke argumentuar shkaqet dhe arsyet për çdo rast. Në raportin e auditimit financiar jepen të detajuara informacionet lidhur me politikat dhe masën e tarifave që arkëtohen nga studentët, mënyrën dhe drejtimit e përdorimit të tyre duke vlerësuar faktin se burimet financiare përdoren në mbështetje të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimeve të lidhura me studentët dhe personelin akademik. <i>Evidenca nr. 47 "Relacion për Realizimin e Buxhetit 2002 dhe planifikimi 2023 KUB"</i> <i>Evidenca nr. 47 "Relacion për Realizimin e Buxhetit 2002 dhe planifikimi 2023 KUB"</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Referuar RVB, Institucioni disponon burime financiare të qëndrueshme, të cilat sigurohen nga të ardhurat nga arkëtimi i tarifave të studimit, si burimi kryesor i të ardhurave, si dhe nga të ardhura të tjera si trajnimet apo pjesëmarrja në projekte të ndryshme, siç është psh Projekti rajonal "Riskman" në kuadër të programit Erasmus+, projekti "Gradua", apo të ardhura nga mobilitetet e personelit akademik dhe studentëve në kuadër të Erasmus+. Institucioni ka aplikuar në disa projekte me financim nga BE, nga ku priten përfitime të mëdha, të cilat do të vihen në dispozicion të mbarëvajtjes së procesit akademik. KUB në vazhdimësi ka siguruar qëndrueshmëri financiare për realizimin e veprimtarisë akademike dhe shkencore të programit të studimit Msc. në "E drejtë Civile dhe Tregtare" dhe të gjithë programeve të tjera të studimit që ofron, sipas bilanceve pozitive të reflektuara në Pasqyrat financiare vjetore.

	<i>Evidenca nr.1 "Statuti i KUB"</i> <i>Evidenca 6 "Regullore e Departamentit të Drejtësisë"</i>			
Konkluzione	<i>Në KUB funksionon Zyra e Programimit dhe Raportimit Financiar. Raporti Vjetor "Mbi veprimtarinë akademike dhe financiare" të KUB, përmban edhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit. Institucioni disponon burime financiare të qëndrueshme, të cilat sigurohen nga të ardhurat nga arkëtimi i tarifave të studimit, trajnimet apo pjesëmarrja në projekte të ndryshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Mbështetur në Ligjin për arsimin e lartë dhe në aktet e brendshme rregullatore, institucioni harton dhe zbaton për studentët politika dhe procedura që realizojnë me sukses mbarëvajtjen e plotë të procesit akademik të studentëve, për të gjithë ciklin e plotë të studimeve, duke nisur që nga publikimi i kriterëve të pranimin, dokumentacionin dhe procedurat e regjistrimit, vijueshmërinë dhe diplomimin e tyre. <i>Evidenca nr 1 "Statuti i KUB"</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

66

	<i>Evidenca nr.4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 5 "Rregullore e Njësië Kryesore FDSHP"</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Institucioni garanton barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit, nëpërmjet politikave dhe procedurave të ndjekura që nga publikimi i kriterëve, pranimi i tyre deri në diplomim. Të drejtat e normuara në aktet rregullatore të IAL-së, janë të qarta dhe kanë qëllim trajtimin e barabartë të të gjithë studentëve. <i>Evidenca nr 1 "Statuti i KUB"</i> <i>Evidenca nr.4 "Rregullore e KUB"</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriterë të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Pranimi në programet e studimit bëhet nëpërmjet kriterëve të parashikuara në ligjin për arsimin e lartë, si dhe kriterëve të veçanta të përcaktuara nga vetë IAL, në varësi të ciklit të studimit. Këto kriterë miratohen nga organet drejtuese të KUB, përcillen në MAS, si dhe publikohen edhe në faqen zyrtare web edhe në fletëpalosjet e përgatitura. KUB ndjek edhe politika të ofrimit të bursave të studimit sipas disa kategorive, për studentët me notë mesatare të lartë si edhe për talentet. Zyra e Këshillimit dhe Karrierës në KUB realizon çdo vit fushata informuese për maturantët e gjimnazeve, në bashkëpunim me Zyrat Vendore Arsimore. <i>Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit;</i> <i>Dok. 104. Fletë Palosje Informative për Vitin Akademik 2023-2024;</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, si dhe çdo informacion tjetër i nevojshëm për studentët publikohen në website-in e institucionit dhe në faqet zyrtare të tij në fillim të çdo viti akademik, para periudhës së aplikimeve për çdo cikël studimi dhe janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. Në lidhje me procedurat e transferimit të studimeve dhe njohjes së studimeve të mëparshme, ato ndiqen nga Komisioni për Ekuivalentimin e Studimeve, i cili del me vendim për çdo student, mbi lëndët/modulet dhe numrin e krediteve të njohura si

	dhe detyrimet e mbartura. Procedurat janë parashikuar në Rregulloren nr. 11, datë 26.11.2018 “Për ekuivalentimin e studimeve”, e ndryshuar. <i>Evidenca nr. 7 “Rregullore e programit të studimit”.</i> <i>Evidenca nr39 “Rregullore për ekuivalentimin e studimeve”</i> <i>Evidenca nr. 40 “Paketa e Regjistrimit të studentit”</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	KUB informon lidhur me programet zyrtare përmes faqes web ku i ofrohet informacion jo vetëm publikut por edhe studentëve të KUB, dhe stafit, lidhur me programet e studimit, karakteristikat e tyre, kurrikulat, si edhe aktivitetet studentore, kulturore dhe shkencore të organizuara nga institucioni. Një sërë aktivitetesh marketingu si reklama, orë të hapura, takime promovuese, të organizuara nga KUB apo publikime si broshuara, synojnë tërheqjen e sa më shumë studentëve. Gjithashtu KUB merr pjesë në panairin Work & Study ku paraqet për publikun informacion të detajuar mbi programet që ofron, procedurat, kriteret e pranimit dhe mundësitë për përfitimin e bursave të studimit (https://kub.edu.al/evente/). <i>Evidenca nr 105 “Guida studentore KUB Viti Akademik 2023-2024”</i> <i>Evidenca nr. 104 “Fletëpalosje Informative për Vitin Akademik 2023-2024”</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Përpara çdo viti akademik me nisjen e procedurave të aplikimit për çdo cikël studimi, KUB harton dhe publikon kuota të veçanta si dhe kriteret e pranimit, mbështetur në legjislacionin përkatës, për pranimin e kandidatëve me aftësi të veçanta, kategoritë e pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Këto kuota dhe kriteret i përcillen edhe ministrisë përgjegjëse për arsimin, pasi miratohen me vendim të Senatit Akademik. <i>Evidenca nr. 47 “Relacion për Realizimin e Buxhetit 2002 dhe planifikimi 2023 KUB”</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve	Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kuota të veçanta dhe kriteret e pranimit për kandidatët nga trojet dhe shtetasit e huaj, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

nga shtete të tjera.	<i>Evidenca nr 106.1 "Propozim i kuotave në MAS 2022-2023"</i> <i>Evidenca nr 106.2 "Miratim i kriterëve në MAS 2023-2024"</i> <i>Evidenca nr 106.3 "Miratim i kuotave në MAS 2022-2023"</i>			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	KUB ndjek politika të mbështetjes së studentëve, nëpërmjet ofrimit të bursave të studimit sipas disa kategorive, për studentët me notë mesatare të lartë, si edhe për talentet dhe studentët me nevoja ekonomike dhe sociale. Institucioni ofron 4 kategori të bursave të studimit sipas notës mesatare, me qëllim rritjen e cilësisë në pranimin e studentëve. https://kub.edu.al/pranimet/bursat <i>Evidenca nr. 47 "Relacion për Realizimin e Buxhetit 2002 dhe planifikimi 2023 KUB"</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni harton dhe zbaton për studentët politika dhe procedura që realizojnë me sukses mbarëvajtjen e plotë të procesit akademik që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Pranimi në programet e studimit bëhet nëpërmjet kriterëve të parashikuara në ligjin për arsimin e lartë, si dhe kriterëve të veçanta të përcaktuara nga vetë IAL, në varësi të ciklit të studimit dhe kategorisë së studentëve. KUB ndjek politika të mbështetjes së studentëve, nëpërmjet ofrimit të bursave të studimit për studentët me notë mesatare të lartë, si edhe për talentet dhe studentët me nevoja ekonomike dhe sociale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në	I gjithë informacioni në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve parashikohet në një sërë rregulloresh në nivel institucional. Kriteret dhe procedura që i

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

69

lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	referohen këtij programi studimi përmban në mënyrë të detajuar rregullorja e posaçme e programit të studimit. Në këtë rregullore parashikohen elementë lidhur me objektivat formues të programit, kohëzgjatjen, frekuentimin, kontrollin e dijeve si dhe instrumentat e vlerësimit. Pranë Sekretarisë Mësimore studentët informohen mbi kalendarin e provimeve, vlerësimet e lëndëve, frekuentimin apo numrin e krediteve për kalimin në vitin pasardhës akademik. Ky informacion mund të aksesohet edhe on-line në faqen zyrtare të institucionit dhe në sistemin e portalit ku pasqyrohen njoftimet e sekretarisë. Nga takimi i GVJ me studentët, u konfirmua se studentët informohen nga pedagogu i lëndës si dhe burime të tjera për aspektet që lidhen me komponentët e lëndëve dhe procedurat e përparimit akademik. <i>Evidenca nr. 4. "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 7. "Rregullore e Programit të Studimit"</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	KUB, bazuar në ligjin për arsimin e lartë, Statutin dhe Rregulloren për Ekuivalentimin e Studimeve, nëpërmjet Komisionit të Ekuivalentimit të Studimeve, kryen procedurat e njohjes së krediteve të fituara nga kualifikimet e mëparshme apo studimet e pjesshme, për lëndët/modulet që janë pjesë e programit të studimit Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare". Kriteret dhe procedurat e parashikuara në këto akte, bëhen publike dhe për to informohen të gjithë studentët, që në momentin e aplikimit. <i>Evidenca nr. 7. "Rregullore e Programit të Studimit"</i> <i>Evidenca nr. 39 "Rregullore për Ekuivalentimin e Studimeve"</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Institucioni, nëpërmjet strukturave të tij, informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të tyre, bazuar edhe në përcaktimet e Rregullores së programit të studimit Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare". Sipas parashikimeve të nenit 10 të Rregullores, vlerësimi i dijeve organizohet nga 1 vlerësimi i vazhduar (pjesëmarrja, aktivizimi, teste/detyra kursi) dhe 2 provimi përfundimtar.




	<i>Evidenca nr.4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 5 "Rregullore e njësisë kryesore FDSHP"</i> <i>Evidenca nr. 7. "Rregullore e Programit të Studimit"</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Institucioni, bazuar në rregulloren e programit të studimit, informon studentët mbi kriteret e punimit të diplomës dhe procedurës së vlerësimit të diplomimit për programin e studimit. Mënyra e informimit është nëpërmjet afishimit në mjediset e IAL-së si dhe publikimit të paketës informuese në website dhe portalit të sekretarisë mësimore. Referuar <i>nenit 52</i> të Rregullores së njësisë kryesore FDSHP, Departamenti i Drejtësisë shpall sipas datave të përcaktuara temat e diplomës. Departamenti miraton gjithashtu edhe udhëheqësit e temave, të cilët marrin miratimin përfundimtr nga Dekani i FDSHP. Në këtë program studimi udhëheqësi i temës së diplomës duhet të ketë të paktën gradën shkencore "Doktor". Studenti i cili ka përmbushur të gjitha detyrimet në raport me përgatitjen dhe paraqitjen e diplomës, në përfundim të studimeve paiset me diplomën përkatëse, cila është një dokument zyrtar. Udhëzimi i posaçëm për punimin e diplomës ka përcaktime të detajuara lidhur me procedurat e realizimit të mbrojtjes, si dhe detyrimet e studentëve dhe kompetencat e strukturave të përfshira në procesin e mbrojtjes si udhëheqësi, Komisioni i Mbrojtjes së Diplomës, etj. Për të garantuar cilësinë dhe për të rritur nivelin shkencor në realizimin e punimeve të diplomës, udhëzimi ka përcaktime të qarta mbi strukturën dhe kriteret e cilësisë në hartimin e përmbajtjes, si dhe etikës së kërkimit. Mbrojtja e diplomës bëhet me temë ose me provim të përgjithshëm, para komisionit të mbrojtjes. <i>Evidenca nr.4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr. 5 "Rregullore e njësisë kryesore FDSHP"</i> <i>Evidenca nr. 7. "Rregullore e Programit të Studimit"</i> <i>Evidenca nr 32.6 "Udhëzues për përgatitjen e diplomës"</i> <i>Evidenca nr. 32.8 "Miratimi i temës së diplomës nga dekani FDSHP"</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në	Procesi i informimit, vlerësohet nga KUB si një instrument i rëndësishëm për të orientuar studentët rreth zgjedhjes më të

mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	mirë për studimet universitare. Informimi mbi kriteret, procedurat dhe dokumentacionin e aplikimit, mbi programet që ofron dhe tarifat e studimit, personelin akademik etj., kryhet para fillimit të çdo viti akademik, nëpërmjet formave të ndryshme si njoftimet në faqen zyrtare dhe rrjetet sociale, televizion dhe me fletëpalosje e broshura informuese. KUB merr pjesë në panairë të ndryshme si ai Work & Study si dhe të realizuara nga shkollat e mesme, me qëllim informimin e publikut dhe të interesuarve mbi programin e studimit Msc “E drejtë Civile dhe Tregtare” dhe jo vetëm. Zyra e Këshillimit dhe Karrierës në KUB realizon çdo vit ditët e informimit dhe takime të hapura informuese për maturantët e gjimnazeve, në bashkëpunim me Zyrat Vendore Arsimore. <i>Evidenca 104 “Fletë palosje informative për vitin akademik 2023-2024”</i> <i>Evidenca 105 “Guida studentore KUB viti akademik 2023-2024”</i> <i>Evidenca 110 “Program i Panairit Work and Study”</i>			
Konkluzione	<i>KUB informon në vijimësi studentët e programit të studimit në lidhje me ecurinë e tyre akademike, kriteret dhe procedurat për njohjen e kualifikimeve apo studimeve të mëparshme, vlerësimin e dijeve dhe aftësive, si dhe kriterëve dhe procedurave për diplomimin e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të	KUB ka zhvilluar Sistemin e Menaxhimit të Informacionit në IAL, nëpërmjet të cilit studentët informohen në mënyrë të




hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit Msc në “E drejtë Civile dhe Tregtare”. Rregullorja e këtij program studimi ka gjithashtu rregullime mbi ngarkesën e lëndëve, kohëzgjatjen dhe kreditet. Programi mësimor Msc në “E drejtë Civile dhe Tregtare” ka një kohëzgjatje prej 2 vitesh akademike me një total prej 120 kreditesh. <i>Evidenca nr. 7. “Rregullore e Programit të Studimit”</i> https://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale/ https://kub.portali.kub.edu.al/hyrje
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Institucioni ofron informacion për studentët në lidhje me lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit, nëpërmjet publikimit të planit mësimor të detajuar, publikimin në Portalin e KUB të syllabuseve të pedagogëve, publikimit të Guidës së studentit etj. Që në javën e parë të vitit akademik, pedagogët e lëndëve informojnë studentët në lidhje me secilën nga lëndët/modulet, përmbajtjen e lëndës, konceptet themelore të saj, sistemin e vlerësimit dhe literaturën. Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve konstatohet se syllabuset kanë të gjithë komponentët e nevojshëm që i referohen lëndës/modulit si pedagogun përgjegjës, tipologjinë e lëndës, numrin e krediteve, ngarkesën mësimore, konceptet themelore, temat e leksioneve, format e kontrollit të njohurive si dhe provimit përfundimtar. Elementë të programit të lëndës janë gjithashtu edhe literatura e detyrueshme si dhe ajo e rekomanduar. <i>Evidenca 32.3 “Planet mësimore të programit të studimit”</i> 32.4 “Syllabus-et e lëndëve Modulet e programit të studimit” <i>Evidenca 105 “Guida Studentore KUB Viti Akademik 2023-2024”</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për	Referuar RVB, në përputhje me Planin strategjik të zhvillimit të programit të studimit Msc në “E drejtë Civile dhe Tregtare”, KUB vlerëson me prioritet jo vetëm zhvillimin cilësor të kurrikulave dhe programit të studimit, por edhe përqasjen e tyre




orientimin drejt dhe në tregun e punës.	ndaj kërkesave profesionale të tregut të punës, që nga krijimi i mundësive për kryerjen e praktikave në sipërmarrje të ndryshme, me të cilat ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi, deri në ndjekjen pas diplomimit dhe orientimin në tregun e punës. Gjithë kjo praktikë u ofrohet në vijimësi si informacion studentëve, në mënyrë që ata të jenë orientuar drejtë dhe të bëjnë zgjedhjen më të mirë për të dalë në tregun konkurrues të punës. <i>Evidenca nr 2 "Plani strategjik i zhvillimit KUB 2021-2026"</i> <i>Evidenca nr 2.2 "Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit"</i> <i>Evidenca nr 9 "Rregullore e Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës"</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Në institucion është ndërtuar një sistem funksional i shpërndarjes dhe përditësimit të informacionit ndaj studentëve, në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor akademik, infrastrukturën dhe shërbimet, si dhe bazën materiale në dispozicion të realizimit sa më të mirë të këtij procesi. Të gjitha materialet informuese që institucioni i bën të njohura publikut përmbajnë informacion edhe mbi infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të procesit mësimor. Këto informacione mund të aksesohen në faqen web të institucionit, në Guidën e Studentit. Në fillimi të vitit akademik, studentët orientohen dhe informohen në lidhje me infrastrukturën në funksion të procesit mësimor. <i>Evidenca nr. 91 "Relacion i bibliotekës së KUB"</i> <i>Evidenca nr.58 "Raport Vjetori i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022"</i> <i>Evidenca nr. 80 "Relacion mbi infrastrukturën e KUB"</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit dhe portali i KUB janë porta përmes së cilave mundësohet akses i lehtë dhe në çdo kohë i informacionit për studentët, në lidhje me të gjitha të dhënat e programit të studimit Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare". Sekretaria mbledh dhe administron dosjen dhe të dhënat për studentët, që nga momenti i regjistrimit në program, deri në

arritshëm nga studentët edhe në distancë.	momentin e diplomimit. Regjistri themeltar i studentëve administrohet jo vetëm në format shkresor, por edhe në format elektronik. Studentët mund të marrin në çdo kohë informacionin e administruar pranë Sekretarisë Mësimore. Vënia në dispozicion e informacionit realizohet në përputhje me parashikimet e akteve të brendshme regullatore. <i>Evidenca nr.66 "Rregullore e Sekretarisë Mësimore"</i> <i>Evidenca nr. 74 "Guida e stafit për përdormin e platformës classroom_KUB"</i> <i>Evidenca nr. 94 "Regjistri i të dhënave të studentëve AMZA"</i> <i>Evidenca nr. 95 "Regjistri i rezultateve të performancës së studentit"</i>			
Konkluzione	<i>Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare", nëpërmjet një sërë burimesh si pedagogët e lëndëve, departamenti, dhe sekretaria mësimore.</i> <i>Institucioni ofron informacion për studentët në lidhje me lëndët/modulet, veprimtaritë formuese të programit, infrastrukturën, mbështetjen dhe orientimin drejt tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e	Bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, KUB disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve aktivë, numrin e të diplomuarve, studentët e çregjistruar etj, për programin e studimit Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare". Këto të dhëna raportohen periodikisht në institucionet përkatëse (MAS, ASCAL, QSHA), sipas udhëzimeve dhe afateve të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

75

studimit.	përcaktuara. Përgjegjëse për administrimin e të dhënave është Sekretaria Mësimore, e cila ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjisalcionin në fuqi si dhe aktet rregullatore të institucionit. Në kuadrin e detyrave të saj për hedhjen dhe administrimin e të dhënave lidhur me studentët që ndjekin këtë program studimi, Sekretaria Mësimore administron një regjistër të veçantë, regjistrin e të diplomuarve. Ky regjistër përmban të dhënat e studentëve që kanë përfunduar me sukses programin e studimit dhe janë diplomuar sipas programeve të studimit. <i>Evidenca nr.66 "Rregullore e Sekretarisë Mësimore"</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sekretaria mësimore e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Politike, përgjegjëse për programin e studimit Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare", disponon statistika lidhur me: - Numrin e studentëve të regjistruar në program dhe ecurinë e tyre deri në diplomim; - Studentët e tërhequr nga programi i studimit; - Studentët e larguar/çregjistruar para përfundimit të programit; - Studentët e klasifikuar jokalue në vitin pasardhës akademik; - Studentët që përmbyllin me sukses programin dhe diplomohen. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizitës në sekretarinë mësimore rezulton se numri i studentëve të regjistruar për këtë program studimi në katër vite është si më poshtë vijon: Viti akademik 2020-2021 22 studentë; Viti akademik 2021-2022 15 studentë; Viti akademik 2022-2023 14 studentë; Viti akademik 2023-2024 9 studentë; <i>Vizita në institucion;</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes	Të dhënat statistikore të studentëve të programit të studimit Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare" administrohen dhe ruhen nga sekretaria mësimore e Fakultetit, në regjistrat themeltarë,




sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	regjistrat e notave, regjistrin e diplomimit, ashtu si edhe në sistemin elektronik të tyre. Sistemi eficient i brendshëm i menaxhimit të informacionit në KUB, mundëson marrjen në çdo kohë të informacionit nga studentët si dhe garanton sigurinë dhe ruajtjen me profesionalizëm të tij. <i>Evidenca nr.66 "Rregullore e Sekretarisë Mësimore"</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Informacioni i administruar në sistemin e menaxhimit të informacionit elektronik është nën mbikëqyrje të vazhdueshme nga njësia e IT, duke garantuar menaxhimin e sigurt të informacionit dhe të dhënave. Kontrolli periodik dhe verifikimi i saktësisë së ruajtjes së informacionit pranë njësive përgjegjëse, realizohet në hierarki të drejtpërdrejtë nga titullari i njësisë përgjegjëse si dhe nga titullarët e njësisë bazë dhe njësisë kryesore, sipas procedurave të parashikuara në aktet e brendshme rregullatore të institucionit të arsimit të lartë. <i>Evidenca nr.66 "Rregullore e Sekretarisë Mësimore"</i> <i>Evidenca nr. 114 "Proces Verbal Verifikimi të dhënash regjistër amze arritje akademike"</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	KUB, në raportet vjetore të veprimtarisë akademiko-financiare, me kontributin e njësisë bazë të FDSHP, evidenton të dhëna analitike lidhur me cilësinë e studentëve duke vlerësuar që nga nota mesatare në pranim, ecurinë dhe notën mesatare në përfundim të programit të studimit Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare". Fakulteti në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës realizon gjurmimin dhe mbajtjen e kontakteve të vazhdueshme me studentët e diplomuar, duke marrë informacion të përditësuar në lidhje me problematikat apo mundësitë e punësimit të tyre, duke kryer edhe seanca orientimi për mundësitë e punësimit të tyre në tregun konkurrues. Kjo zyrë harton çdo vit raporte duke analizuar shkallën e punësimit, sektorët ku janë punësuar studentët e programit të studimit Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare". <i>Dok. 30. Raporti vjetor i veprimtarive FDSHP, Viti Akademik 2022-2023;</i> <i>Dok. 42. Raporti vjetor i veprimtarive të Zyrës së Studentit dhe</i>

	Këshillimit të Karrierës; Dok. 58. Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022;			
Konkluzione	KUB mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programin e studimit Msc në “E drejtë Civile dhe Tregtare”, që nga pranimi i tyre deri në diplomim, duke ndjekur edhe më tutje ecurinë e punësimit të tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në Statutin e KUB, neni 17, neni 23 dhe neni 73, si dhe në Rregulloren e institucionit, janë parashikuar angazhimi dhe përfshirja e studentëve ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, si psh pjesë e Senatit Akademik, Këshillit Studentor, Këshillit të Etikës. Një mekanizëm mjaft i rëndësishëm në këtë drejtim, janë Këshillat Studentorë nëpërmjet të cilave mundësohet përfaqësimi i studentëve në organet drejtuese. Neni 73 i Statutit parashikon se Këshillat e Studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha aspektet me interes të përgjithshëm si, planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtarinë mësimore, cilësinë e shërbimeve, zhvillimin e veprimtarive kulturore dhe sportive etj. <i>Evidenca nr 1 “Statuti i KUB”</i> <i>Evidenca nr.4 “Rregullore e KUB”</i> <i>Evidenca 11.1 “Anëtarët e Këshillit të Etikës”</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet	Në KUB janë ngritur dhe funksionojnë Këshillat studentorë, si

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

78

të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	organizma të pavarur që realizojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të institucionit dhe në struktura të tjera mësimore-kërkimore. Sipas përcaktimeve në aktet e brendshme rregullatorë, studentët janë pjesë e strukturave drejtuese si në Senatin Akademik, NJSBC, Këshillin e Etikës, Grupet e vlerësimit të brendshëm etj, duke patur një rol aktiv, real dhe përfaqësues në këto organizma. Përfshirja e studentëve në organet vendimmarrëse të institucionit u mundëson atyre të përcjellin shqetësimet e tyre mbi procesin akademik si dhe aspektet që lidhen me jetën studentore. <i>Evidenca nr 1 "Statuti i KUB"</i> <i>Evidenca nr.4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr 46 "Raport Vjetor i NJSBC Viti Akademik 2022-2023"</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Studentët e KUB, përmes përfaqësuesve të Këshillit Studentor, marrin pjesë dhe përfshihen në takimet që organizon departamenti dhe fakulteti për shqyrtimin dhe miratimin e programit të studimit Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare", duke dhënë mendimin dhe sugjerime për rishikimin apo përmirësimin e programit. Përveç pjesëmarrjes me përfaqësim, studentët përfshihen në dhënien e mendimeve dhe vlerësimeve të tyre edhe nëpërmjet pyetësorëve, fokus grupe etj. Mendimi i studentëve mundësohet edhe nëpërmjet përfaqësimit të tyre në organet më të larta vendimmarrëse si Senati Akademik. Senati Akademik është struktura më e lartë e cila bën miratimin përfundimtar të programeve mësimore, si dhe miraton përmirësimet apo ndryshimet e përmbajtjes së tyre deri në 20%. Nëpërmjet përfaqësuesit të tyre në Senat, studentët mund të shprehin mendimin e tyre dhe të japin sugjerime mbi përmirësimin e përmbajtjes së programeve mësimore. <i>Evidenca nr 42 "Raport Vjetor i veprimtarive të ZSKK 2022-2023"</i> <i>Evidenca nr 46 "Raport i NJSBC për Vitin Akademik 2022-2023"</i>




	<i>Evidenca nr. 59.2 "Format Vlerësimi i Studentëve IQE"</i>			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Bazuar në Rregulloren e programit të studimit Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare", si dhe në Rregulloren për Zhvillimin e provimeve, përcaktohen të gjitha rregullat për kontrollin e dijeve të studentit dhe ecurinë e tij, si dhe për të drejtën dhe procedurën e ankimimit të studentëve mbi vlerësimin apo rishikimin e tij. Studentet shprehin mendimin e tyre mbi procedurën dhe shkallën e vlerësimit të dijeve të tyre, nëpërmjet sistemit të ankimimit. E drejta e ankimimit si një nga të drejtat bazike të studentëve, është pjesë përbërëse e katalogut të të drejtave. Në rregulloret e brendshme ka një sërë parashikimesh mbi sistemin e ankimimit, afatet, procedurat si dhe organet ku mund të drejtohet ankesa. Rregullime të detajuara në këtë drejtim përcakton Rregullorja për Zhvillimin e Provimeve. <i>Evidenca nr. 4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr 7 "Rregullore e Programit të Studimit"</i> <i>Evidenca nr. 64 "Rregullore për zhvillimin e provimeve"</i>			
Konkluzione	Bazuar në Statutin e KUB, si dhe në Rregulloren e institucionit, KUB përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të shqyrtimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare", duke patur një rol aktiv, real dhe përfaqësues në këto organizma.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme	Bazuar në nenin 82 të Rregullores së KUB, si dhe Rregullores për "Zyrën e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës", në KUB

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.asc.al

80

në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	është ngritur dhe funksionon Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK) si një strukturë e posaçme që organizon, menaxhon dhe drejton procesin e rekrutimit të studentëve të rinj, mban marrëdhënie të vazhdueshme me këshillat studentorë, drejton procesin e këshillimit të studentëve dhe orientimin drejt tregut të punës. ZSKK e organizon punën e saj nëpërmjet Udhëzuesit të Karrierës, të përgatitur si një dokument me karakter informues e mbështetës në drejtim të përgatitjes së studentëve të programit të studimit Msc. “E drejtë Civile dhe Tregtare” për kërkesat e tregut të punës. Gjithashtu studentëve u ofrohet informacion dhe shërbim nga zyra e sekretarisë mësimore të Fakultetit, në lidhje me organizimin e procesit mësimor, provimet, vlerësimin, dokumentacionin shkollor, organizimin e eventeve të ndryshme etj. <i>Evidenca nr 9 “Rregullore e Studentit dhe e Këshillimit të Karrierës”</i> <i>Evidenca nr.66 “Rregullore e Sekretarisë Mësimore”</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	KUB ka ndërtuar një sistem për menaxhimin e informacionit online bazuar në platformën “Portali i KUB”, i cili administron të gjithë informacionin dhe materialet didaktike në funksion të procesit akademik. Web page i KUB është një platformë dinamike, në përditësim të vazhdueshëm dhe që mundëson shpërndarjen e shpejtë të informacionit mbi veprimtarinë e institucionit. Nëpërmjet këtyre platformave KUB bën të mundur informimin e studentëve, të interesuarve, partnerëve dhe opinionin publik në lidhje me rogramet e studimit që ofron, këshillimin për karrierën, ndjekjen dhe përparimin e studentëve, si dhe asistimin e tyre për çështje lidhur me procesin mësimor. <i>Evidenca nr. 74 “Guida e stafit për përdorimin e platformës classroom_KUB”</i> <i>Evidenca nr. 96 “Guida e studentit për përdorimin e platformës classroom_KUB”</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët	Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK) është organizuar dhe funksionon mbështetur në Rregulloren e KUB dhe në bazë të Rregullores për “Zyrën e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës”, miratuar me vendim të Senatit Akademik. ZSKK e organizon punën e saj në drejtim të

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

81




në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	mbështetjes, informimit, udhëzimit dhe gjurmimit të studentëve sipas një plani vjetor të veprimtarive të saj. Për t'u gjendur sa më pranë studentëve Zyra ka përgatitur edhe Udhëzuesin e Karrierës, si një dokument me karakter informues e mbështetës në drejtim të përgatitjes së studentëve të programit të studimit Msc. "E drejtë Civile dhe Tregtare" për kërkesat e tregut konkurrues të punës. <i>Evidenca nr. 4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr 9 "Rregullore e Studentit dhe e Këshillimit të Karrierës"</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	ZSKK, bazuar në rregulloren e saj dhe planit vjetor të veprimtarive, ndjek dhe harton raporte periodike për kryerjen e praktikave profesionale në fushën e studimit të studentëve, si edhe ndjek dhe raporton në lidhje me gjurmimin dhe punësimin e studentëve pas diplomimit në programin e studimit Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare". <i>Evidenca nr 9 "Rregullore e Studentit dhe e Këshillimit të Karrierës"</i> <i>Evidenca nr 41 "Plani Vjetor i Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës"</i> <i>Evidenca nr 42 "Raporti vjetori i veprimtarive të Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës"</i>
Konkluzione	Bazuar në aktet e brendshme rregullatore të institucionit, në KUB është ngritur dhe funksionon Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK) si një strukturë e posaçme që organizon, menaxhon dhe drejton procesin e rekrutimit të studentëve të rinj, mban marrëdhënie të vazhdueshme me këshillat studentorë, drejton procesin e këshillimit të studentëve dhe orientimin drejt tregut të punës. ZSKK, bazuar në rregulloren e saj dhe planit vjetor të veprimtarive, ndjek dhe raporton në lidhje me gjurmimin dhe punësimin e studentëve pas diplomimit në programin e studimit Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare".
Shkalla e përmbushjes së	Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet

standardit	përmbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Bazuar në Rregulloren e programit të studimit Msc në “E drejtë Civile dhe Tregtare”, elementët formues të programit janë leksionet, seminarët, ushtrimet, projektet dhe detyrat e kursit, praktika profesionale, provimet dhe përgatitja e mikrotezës. Në përputhje me objektivat e programit, për një mësimdhënie që nxit mendimin kritik e krijues të studentit, një nga format më të rëndësishme të mësimdhënies është ajo interaktive me në qendër studentin. KUB ka përgatitur udhëzuesin për krijimin dhe menaxhimin e portalit, dedikuar përdoruesve të brendshëm të institucionit, i cili lidh edhe platformën e mësimdhënies online. Platforma e mësimdhënies e aplikuar në KUB është Google for Education. Për lehtësi aksesit dhe përdorimi, është përgatitur edhe paketa udhëzuese mbi hapat për krijimin dhe zhvillimin e procesit nëpërmjet klasave online për studentët dhe personelin akademik. <i>Evidenca nr. 2. “Plani Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026”</i> <i>Evidenca 14.1 “Politikat e zhvillimit të cilësisë në KUB”</i> <i>Evidenca 74 “Guida e stafit për përdorimin e platformës Classroom KUB</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

83

Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në kuadrin e veprimtarisë së saj, në fushën e sigurimit të brendshëm të cilësisë, realizon vlerësime periodike për veprimtarinë mësimore dhe atë kërkimore shkencore. Kjo zyrë vlerëson një herë në vit efikasitetin e veprimtarive mësimore kërkimore, financiare dhe administrative të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Politike pjesë e të cilit është edhe Departamenti i Drejtësisë, njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi. Drejtuesi i Departamentit të Drejtësisë, në kuadrin e kompetencave të përcaktuara në Rregulloren e njësisë bazë, mbikqyr veprimtarinë mësimore dhe shkencore të stafit. Sigurimi i brendshëm i cilësisë në nivel institucional është detyrë e Senatit Akademik si organi më i lartë vendimmarrës. Për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë, në nivel institucional funksionon Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë. <i>Evidenca nr. 2. "Plani Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026"</i> <i>Evidenca nr 6 "Rregullore e Departamentit të Drejtësisë"</i> <i>Evidenca nr 14 " Rregullore e Zyrës së NJSBC"</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimin të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Format dhe metodat e mësimdhënies së stafit akademik janë komponent i vlerësimin të brendshëm të cilësisë. Si të tilla, ato vlerësohen dhe monitorohen nga strukturat e brendshme të vlerësimin të cilësisë. KUB ka ngritur një sërë mekanizmash të vlerësimin të cilësisë duke mundësuar përfshirjen dhe shprehjen e opinionit të studentëve në këtë proces. Një nga komponentë e vlerësimin të cilësisë është vlerësimi në fund të çdo semestri i cilësisë së çdo lënde/moduli si dhe aftësisë së mësimdhënies. Mekanizmi tjetër në këtë drejtim janë pyetësorët e studentëve, nëpërmjet të cilëve ata vlerësojnë përmbajtjen e programeve të lëndëve si dhe procesin dhe aftësitë e mësimdhënies. Rezultatet e këtyre pyetësorëve bëhen pjesë e raporteve që NJSBC përgatit, i shpërndan në fakultet dhe departament, si dhe në Rektorat. <i>Evidenca nr 14 " Rregullore e Zyrës së NJSBC"</i> <i>Evidenca 46.3 "Format Pyetësori i Studentit KUB"</i> <i>Evidenca 59.3 Raport i IQE për studentët 2021"</i>




Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, në bashkëpunim me FDSHP dhe Departamentin e Drejtësisë, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit, nëpërmjet analizave periodike dhe vjetore të kryera. Në këto raporte përfshihen edhe rezultatet e përfuara nga pyetësorët e studentëve. Këto rezultate publikohen në faqen zyrtare të KUB, bëhen pjesë edhe e raportit vjetor të institucionit i cili përcillet në MAS dhe publikohet në web. <i>Evidenca nr 14 “ Rregullore e Zyrës së NJSBC”</i> <i>Evidenca nr 46.1 “Vendim i SA për miratimin e raportit vjetor të NJSBC”</i> <i>Evidenca 59.3 Rraport i IQE për studentët 2021”</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Institucioni përdor rezultatet e mekanizmave të vlerësimit të cilësisë në kuadër të promovimit të praktikave të mira dhe nxitjes së personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të procesit të mësimdhënies. Personeli akademik i KUB nxitet të realizojë kualifikimin e vazhdueshëm nëpërmjet pjesëmarrjes në vizita dhe mobilitete, leksione të hapura dhe prezantime në konferenca shkencore, në kuadër të marrëveshjeve që ka KUB me institucione të tjera të arsimit të lartë dhe jo vetëm, vendase dhe të huaja. Institucioni mban evidenca dhe të dhëna për bashkëpunimet kombëtare dhe ndërkombëtare të FDSHP. Institucioni nxit, inkurajon dhe mbështet mobilitetin e stafit akademik të programit të studimit Msc në “E drejtë Civile dhe Tregtare”, me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe metodave të mësimdhënies brenda dhe jashtë vendit, si dhe promovimin e kërkimit shkencor si një komponent i rritjes së cilësisë në mësimdhënie. <i>Evidenca A. 3.42 “Raport Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022”</i> <i>Evidenca nr 69 “Raport Vjetor i Punës Kërkimore dhe Shkencore dhe Projektet, KUB”</i> <i>Evidenca nr 75 “Plani i aktiviteteve për përmbushjen e rezultateve të pyetësorëve në kuadër të përmirësimit të standarteve të cilësisë në KUB</i>




Konkluzione	KUB ndjek një politikë të qartë për rritjen, promovimin dhe sigurimin e cilësisë së mësimdhënies, nëpërmjet metodave interaktive dhe shkëmbimit të përvojave të mira. Në KUB është ngritur një sistem i sigurimit dhe zhvillimit të cilësisë, përmes udhëzuesit të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit. Personeli akademik i programit të studimit Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare" dhe jo vetëm, nxitet të realizojë kualifikimin e vazhdueshëm nëpërmjet pjesëmarrjes në vizita dhe mobilitete, leksione të hapura dhe prezantime në konferenca shkencore, në kuadër të marrëveshjeve që ka KUB me institucione të tjera të arsimit të lartë dhe jo vetëm, vendase dhe të huaja.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Me qëllim garantimin e cilësisë, efektshmërisë së kërkuar dhe përmbushjes së standardeve, KUB e mbështet punën në dy struktura akademike që janë Senati Akademik dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC). Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) është ngritur dhe funksionon në përputhje me nenin 103 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutin e IAL si dhe Rregullores "Mbi funksionimin e NjSBC në IAL KUB". Politika për sigurimin e standardeve të cilësisë mbështetet në Ligjin për arsimin e lartë, në standardet dhe udhëzimet për sigurimin e cilësisë në hapësirën europiane, në Kodin e Cilësisë së arsimit të lartë. <i>Evidenca nr 1. "Statuti i KUB"</i>

	<i>Evidenca nr 2 "Plani Strategjik i Zhvillimit të KUB 2021-2026"</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Në përputhje me politikat e zhvillimit të cilësisë, institucioni ka zhvilluar sistemin e tij të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Të gjitha strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë duhet të respektojnë standartet, parimet dhe objektivat e sigurimit të cilësisë në nivel institucional. Senati Akademik i KUB është organi kryesor përgjegjës që garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion në përputhje me standartet shtetërore. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është një njësi e pavarur që vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore, kërkimore dhe shkencore. Kjo njësi i raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë Rektorit mbi rezultatet e evidentuara. Referuar Statutit të KUB, kjo njësi harton standartet për sigurimin e cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë, harton dhe organizon pyetësorin me studentët për cilësinë e programeve dhe performancës së pedagogëve, realizon studime gjurmuese mbi cilësinë e punësmit të studentëve. <i>Evidenca nr 1 "Statuti i KUB"</i> <i>Evidenca nr 2 "Plani Strategjik i Zhvillimit të KUB 2021-2026"</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë, bazuar në instrumentet dhe treguesit zyrtarë të Kodit të cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë kryhet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm, siç janë akreditimi, vlerësimet analitike e krahasuese, si dhe procese të tjera që promovojnë dhe përmirësojnë cilësinë. Vlerësimi i jashtëm i cilësisë kryhet nga ASCAL me ekspertë të jashtëm, përmes procesit të akreditimit. KUB ka konsoliduar mekanizmat e sigurimit të cilësisë, përmes të cilëve realizon vlerësimin e ecursisë së programeve të studimit. Instrumentet matëse dhe vlerësuese janë të drejtpërdrejta dhe të tërthorta.
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes,	Procesi i vlerësimit të brendshëm të cilësisë realizohet nga NjSBC, mbështetur në tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim. Ky proces përfshin mbledhjen sistematike të të dhënave administrative, anketimin e studentëve




arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	dhe të diplomuarve, intervistimin e pedagogëve dhe studentëve, analizimin e rezultateve të kontrolleve periodike të realizuara nga anëtarët e kësaj njësie lidhur me syllabuset e lëndëve, provimet etj. Në përfundim të analizës së kryer, NjSBC publikon rezultatet dhe harton raportin, duke marrë në konsideratë promovimin e nxitjes për arritjet më të mira. <i>Evidenca nr 1 "Statuti i KUB"</i> <i>Evidenca nr 4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr 14.1 "Politikat e zhvillimit të cilësisë"</i>			
Konkluzione	<i>KUB ka hartuar dhe zbaton politika e procedura transparente për sigurimin e cilësisë së programit të studimit Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare". Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) është ngritur dhe funksionon në përputhje me nenin 103 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutin e IAL si dhe Rregullores "Mbi funksionimin e NjSBC në IAL KUB"</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë	KUB, nëpërmjet NjSBC në bashkëpunim me njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare" dhe Zyrën e Kurrikulave, kryen monitorimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit, sipas standardeve shtetërore të cilësisë, duke respektuar lirinë akademike. Kjo njësi, para çdo sezoni provimesh, mbledh të dhëna për perceptimin e studentëve lidhur me mësimdhënien dhe mësimnxënien për programin e studimit. Të gjitha të dhënat e mbledhura nëpërmjet

akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	mekanizmave dhe instrumenteve të përdorur nga NjSBC analizohen dhe mbi to hartohet një raport vjetor, i cili u vihet në dispozicion autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit, si dhe publikohet në faqen zyrtare të institucionit. <i>Evidenca nr 6 "Rregullore e Departamentit të Drejtësisë"</i> <i>Evidenca nr 8 "Rregullore e Zyrës së Kurrikulave"</i> <i>Evidenca nr 28 "Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022"</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	KUB përdor një sërë instrumentash të vlerësimit të komponentëve të cilësisë. Nëpërmjet këtyre instrumentave, institucioni vlerëson programet e studimit që ofron, cilësinë e mësimdhënies si dhe kualifikimin shkencor të stafit akademik, standartet e infrastrukturës etj. Gjetjet dhe konkluzionet që rezultojnë nga proceset e vlerësimit, janë objekt i raporteve të strukturave përgjegjëse për sigurimin e cilësisë. Raportet e vlerësimit të NjSBC përfshijnë rezultatet e pritshme dhe të vlerësimit, përmirësimin dhe masat që do të ndërmerren në vijim, për sigurimin e cilësisë. Raportet përmbajnë synimet e mëtejshme të përmirësimit të procesit akademik në përgjithësi dhe atë të programit të studimit, që pasqyrohen edhe në analizën vjetore të veprimtarisë së Departamentit të Drejtësisë, përgjegjës për programin e studimit Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare", me qëllim adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë. <i>Evidenca nr 3 "Plani i masave të KUB për vitin akademik 2022-2023"</i> <i>Evidenca nr 28 "Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022"</i> <i>Evidenca nr 30 Evidenca nr 31 "Raporti vjetor i veprimtarive FDSHP Viti Akademik 2022-2023"</i>
Kriteri 3. Institucioni, në	Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se KUB, në kuadër të

kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes dhe cilësisë së programit të studimit Msc në “E drejtë Civile dhe Tregtare”, përdor një sërë metodash, dhe instrumentash të drejtpërdrejta të vlerësimit. Këto metoda i referohen si vlerësimit të kurrikulës dhe përmbajtjes së programit të studimit, ashtu edhe vlerësimit të komponentëve të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Departamenti si njësi përgjegjëse bazë për zbatimin e programit të studimit është struktura kryesore që vë në zbatim metodat e drejtpërdrejta të vlerësimit të mësimdhënies. Disa nga metodat e drejtpërdrejta të përdorura për vlerësim janë: - Rezultatet e studentëve janë arritur përmes testimeve të pjesshme dhe testeve përfundimtare të standardizuara në nivel IAL-je. - Vlerësimet e studentëve janë bërë edhe nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në auditor. - Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit, si punë individuale ose punë në grup, detyra kursi, projekte, provime. - Vëzhgimet dhe vlerëimet gjatë kryerjes së praktikave; <i>Vizita në insitucion;</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin	Për realizimin e vlerësimit për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit Msc në “E drejtë Civile dhe Tregtare”, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit. Disa nga mekanizmat dhe instrumentet e matjes dhe vlerësimit të tërthortë të sigurimit të cilësisë janë: - Realizimi i pyetësorëve me stafin; - Realizimi i pyetësorëve me studentët; - Raportet e Zyrës së Këshillimit të Karrierës për gjurmimin e studentëve dhe ALUMNI; - Përhapja dhe shkëmbimi i përvojës ndërmjet pedagogëve;




e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	- Veprimtaria kërkimore shkencore e personelit akademik; - Analiza vjetore e veprimtarisë së Departamentit të Drejtësisë; - Analiza vjetore e veprimtarisë së FDSHP mbi performancën e procesit mësimor akademik;			
Konkluzione	<i>KUB monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme (NjSBC, Zyra e Kurrikulës, Zyra e Karrierës, Njësia bazë) dhe në mënyrë periodike programin e studimit Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare", për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet. Për realizimin e vlerësimit për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare", institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitet akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	KUB i ka pasqyruar në akte të posaçme politikat e cilësisë, të cilat hartohen dhe orientohen me qëllim përputhjen me planet strategjike të zveçillimit. Një sërë strukturash si Senati Akademik, NJSBC, Zyra e Kurrikulave, fakultetet, departamentet etj, ushtrojnë kompetencat e tyre në vlerësimi priodik të komponentëve të cilësisë. Në këtë proces përfshihen edhe studentët, të cilët shprehin mendimin e tyre nëpërmjet pyetësorëve dhe sondazheve. Institucioni nëpërmjet proceseve gjurmuese përpiket të mbajë kontakte dhe të përfshijë në këto procese edhe studentët Alumni.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

91

	<i>Evidenca 14.1 "Politikat e zhvillimit të cilësisë"</i> <i>Evidenca nr 59.3 "Raport i IQE për studentët 2021"</i> <i>Evidenca nr 59.3 "Raport i IQE për Stafin Akademik 2021"</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, në KUB është ngritur dhe funksionon NjSBC, roli i të cilës është krijimi i një kulture që synon arritjen dhe ruajtjen e cilësisë së lartë të veprimtarisë akademike dhe kërkimore në këtë IAL. Përbërja, përgjegjësitë dhe detyrat konkrete të NjSBC dhe çdo njësie tjetër përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, përcaktohen në aktet e brendshme rregullatorë të IAL-së, si Statuti, Rregullore e KUB, Rregullore e NjSBC etj. <i>Evidenca nr 4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca 14.1 "Politikat e zhvillimit të cilësisë"</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Vlerësimi dhe siguri i cilësisë së programit të studimit Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare" bëhet nga NjSBC në bashkëpunim me njësinë kryesore dhe njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit, si edhe me përfshirjen e anëtarëve të personelit akademik dhe studentëve të programit. Në rregulloret e njësive kryesore dhe njësive bazë, përcaktohen roli dhe përgjegjësitë e këtyre njësive në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë të programeve të studimit që mbulojnë. Përbërja e njësive të sigurimit të cilësisë si NJSBC nga personel akademik dhe përfaqësues të studentëve, mundëson një bashkëpunim më të mirë të kësaj njësie me personelin akademik dhe studentët në proceset e vlerësimit të programeve të studimit. Ky bashkëpunim ka lehtësuar proceset e vlerësimit të brendshëm të cilësisë si vlerësimi i performancës së stafit, vlerësimi nga studentët i programit të studimit etj. <i>Evidenca nr 1 "Statuti i KUB"</i> <i>Evidenca nr 4 "Rregullore e KUB"</i> <i>Evidenca nr 5 "Rregullore e Njesisë Kryesore FDSHP"</i> <i>Evidenca nr 6 "Rregullore e Departamentit të Drejtësisë"</i>

	<i>Evidenca 65 "Vlerësim performance stfi-TIP"</i>			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Nga vizita në IAL u kuptua që ky kriter plotësohej për proceset e vlerësimit që janë realizuar deri tani, përmendim këtu që IAL ka kaluar proces të vlerësimit dhe akreditimit institucional si dhe programe studimi. Këto procese e kanë ndihmuar institucionin të identifikojë fushat e përmirësimit në procesin e vlerësimit të cilësisë së programit të studimit. Evidentimi si pikë e dobët dhe më tej si rekomandim në procesin e vlerësimit dëshmon hapin e parë në procesin e vlerësimit.			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Referuar RVB, strukturat përgjegjëse të IAL-së zhvillojnë takime me bashkëpunëtorë nga institucione publike dhe private mbi studimin e tregut të punës, duke mbajtur lidhje të vazhdueshme me to për të siguruar vlerësime sa më të besueshme, të pavarura dhe profesionale, në kuadër të përmirësimit të cilësisë së programit që ofron. KUB ka marrëveshje me kompaninë private IQE, e cila organizon çdo vit pyetësorët me studentët dhe personelin akademik sa i takon vlerësimit të performancës dhe aspekteve të tjera akademike.			
Konkluzione	<i>KUB ka parashikuar dhe garantuar në "Politikat e Zhvillimit të Cilësisë" përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare". Vlerësimi dhe siguri i cilësisë së programit të studimit Msc në "E drejtë Civile dhe Tregtare" bëhet nga NjSBC në bashkëpunim me njësinë kryesore dhe njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit, si edhe me përfshirjen e anëtarëve të personelit akademik dhe studentëve të programit. Vlerësimi i cilësisë bëhet edhe nga kompania private IQE.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Aktet e brendshme të KUB, si Statuti dhe Rregullorja e KUB, apo akte të tjera rregullatore, kanë parashikime që i referohen procedurave dhe strukturave të sigurimit të cilësisë. Tërësia e akteve rregullatore të tilla dhe dokumentave të tjerë si, raportet vjetore të veprimtarisë së NJSBC, bëhen publike për studentët dhe gjithë të interesuarit nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të institucionit dhe janë lehtësisht të aksesueshme në faqen web të institucionit. <i>https://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ vëren se publikimi i rezultateve të vlerësimit të programit të studimit bëhet në përputhje me ligjin dhe aktet e KUB. Qëllimi i vlerësimit është paraqitja e të dhënave mbi programet e studimit dhe përmirësimi i tyre. Nga shqyrtimi i raporteve të publikuar në faqen e KUB, nuk rezulton që të jetë çënuar liria akademike apo të dhënat personale.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Raporti vjetor i sigurimit të brendshëm të cilësisë shoqërohet me një analizë SWOT ku evidentohen pikat e forta dhe pikat e dobëta, si edhe përmban rekomandime për masa dhe përmirësime. Institucioni, pasi ka analizuar rezultatet dhe dobësitë e evidentuara, përgatit planin e aktiviteteve dhe masave në përmbushje të rezultateve, në kuadër të përmirësimit të standardeve të cilësisë dhe mbarëvajtjen e aspekteve të veçanta akademike apo administrative.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit	Harmonizimi i aktivitetit të strukturave të ndryshme të institucionit me NJSBC siguron koherencë dhe gjithëpërfshirje në drejtim të sigurimit të cilësisë falë mbledhjes së të dhënave dhe analizës së informacionit duke hartuar sugjerimet dhe përmirësimet përkatëse. NJSBC harton një raport vjetor ku përfshin veprimtarinë që kjo strukturë ka realizuar për të ndjekur dhe monitoruar aktivitetet e programeve mësimore me qëllim

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

94

të studimit.	përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë.			
	Dok. 46. Raporti vjetor i NJSBC Viti Akademik 2022-2023;			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni, nëpërmjet Njesisë përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë (NjSBC) organizon veprimtari periodike me personelin akademik dhe studentët, me fokus informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit Msc në “E drejtë Civile dhe Tregtare”. Çdo fillim dhe fund semestri organizohen takime të përbashkëta të përfaqësuesve të njesisë bazë përgjegjës për programin e studimit, me anëtarë të NjSBC dhe studentë, ku merren mendimet dhe opinionet e secilit në lidhje me vlerësimin për cilësinë e mësimdhënies, dhe aspekteve të tjera akademike dhe infrastrukturore. Synimi është gjithëpërfshirja e studentëve në proceset organizative dhe vendimmarrëse të institucionit. Studentët janë përfshirë edhe në procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë në kuadër të akreditimit periodik të programit të studimit Msc në “E drejtë Civile dhe Tregtare”, nëpërmjet përfaqësuesit të tyre. Ky proces në vetvete ka kërkuar angazhimin dhe zhvillimin e takimeve dhe veprimtarive periodike me personelin akademik, studentët dhe të gjithë organizmat etjerë të institucionit. Dok. 59.3. Raporti i IQE për Stafin Akademik, 2021; Dok.59.4. Raporti i IQE për studentët, 2021;			
Konkluzione	Politikat, strategjitë, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë parashikuar në dokumentet e brendshme të IAL-së si Plani Strategjik i Zhvillimit të KUB, Politikat e Sigurimit të Cilësisë dhe Raporti Vjetor i NjSBC, të cilat janë transparente, publike dhe lehtësisht të aksesueshme për studentët, personelin akademik dhe të interesuarit. Në kuadër të përmirësimit të standardeve të cilësisë dhe mbarëvajtjen e aspekteve të veçanta akademike apo administrative organizohen takime periodike, si dhe hartohet plani i masave që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.			
Shkalla e përmbushjes së	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

95

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “E drejtë Civile dhe Tregtare”

1. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit Master i Shkencave në “E drejtë Civile dhe Tregtare”, organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore, si në formë ashtu edhe në përmbajtje;
2. IAL ka të hartuara, të miratuara dhe zbaton politika e procedura të dedikuara për sigurimin e cilësisë për të gjitha programet e studimit, përfshirë edhe programin Master i Shkencave në “E drejtë Civile dhe Tregtare”, NJSBC funksionon dhe ndërvepron në mënyrë të plotë dhe profesionale;
3. Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit;
4. Përfshirja e studentëve në vendimmarrje. Institucioni ka mundësuar studentëve, që jo vetëm të informohen rreth zhvillimeve të institucionit, por të kenë mundësinë për të qenë pjesë e vendimmarrjes në struktura të rëndësishme si NJSBC, ose ZSKK dhe deri në Senatin Akademik;
5. Institucioni, mbështet financiarisht stafin / studentët në veprimtari të kërkimit shkencor, si dhe në pjesëmarrje në projekte të ndryshme kërkimore, janë realizuar mobilitete stafi, me IAL europiane, duke shkëmbyer eksperiencat profesionale por edhe duke sjellë një frymë perëndimore në këtë drejtim;

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

96




6. Mbështetja e studentëve, bursat dhe tarifat e studimeve të aplikuara në Institucion si dhe për këtë program studimi, janë konkurruese dhe motivuese për studentët, gjë kjo e reflektuar në cilësinë e studentëve të pranuar;
7. Zyra e Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës, ofron dhe orienton këshillim karriere asiston dhe ndjek studentët, si gjatë kohës së ndjekjes së studimeve, ashtu edhe pas mbarimit të saj, duke krijuar një database me të dhëna për karrierën, suksesin dhe vështirësitë e studentëve gjatë përshtatjes në treg, arritjet e tyre;

2. Pika të dobta:

1. Mospërputhja e disa lëndëve në kurrikulën e programit të studimit, me profilin civile dhe tregtare të programit të studimit; (*Standarti II.4, kriteri 3*)
2. Mosmbulimi në masën 70% i ngarkesës mësimore të programit të studimit nga staf akademik efektiv, në përputhje me aktet ligjore në fuqi, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017; (*Standarti IV.1, Kriteri 2*)

Rekomandime:

1. Të rishikohet kurrikula e programit të studimit, me qëllim zëvendësimin e disa lëndëve që nuk përputhen me profilin e këtij program studimi;
2. Institucioni të rekrutojë staf akademik efektiv, për të mbuluar ngarkesën e orëve në auditor mbi masën 70%, në përputhshmëri me aktet ligjore në fuqi;
3. Institucioni të vë sa më të shpejt në përdorim sistemin elektronik të testimit dhe vlerësimit të provimeve, si një mjet për shmangien e abuzimit, dhe rritjen e transparencës;
4. Institucioni të angazhojë personel ndihmës akademik në kuadër të realizimit të praktikave mësimore;

Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle Master of Science in "Civil and Commercial Law"

a. Strengths and Affirmations:

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

97



1. The Master of Science study program in "Civil and Commercial Law" is organized in accordance with the legal and by-law provisions in force and internal regulatory acts, both in form and in content;
2. HEI has drafted, approved and implements policies and procedures dedicated to quality assurance for all study programs, including the Master of Science program in "Civil and Commercial Law", NJSBC functions and interacts fully and professionally;
3. The academic personnel covering the study program meet the quantitative standards and have the appropriate and special academic qualification in accordance with the field of the program, to guarantee the teaching standards of the study program;
4. Involvement of students in decision-making. The institution has enabled students not only to be informed about the institution's developments, but to have the opportunity to be part of decision-making in important structures such as NJSBC, or ZSKK and even the Academic Senate;
5. The institution financially supports the staff/students in scientific research activities, as well as in participation in various research projects, staff mobility has been carried out with European HEIs, exchanging professional experiences but also bringing a western spirit in this direction;
6. Student support, scholarships and study fees applied at the Institution as well as for this study program are competitive and motivating for students, which is reflected in the quality of accepted students;
7. The Office of Students and Career Counseling offers and guides career counseling, assists and follows students, both during the time of studying, and after its completion, creating a database with data on the career, success and difficulties of students. during the adaptation to the market, their achievements;

b. Weak points:

1. Inconsistency of some subjects in the curriculum of the study program, with the civil and commercial profile of the study program; (*Standard II.4, criterion 3*)
2. Failure to cover 70% of the teaching load of the study program by effective academic staff, in accordance with the legal acts in force, according to VKM No. 418, dated 10.05.2017; (*Standard IV.1, Criterion 2*)

Recommendations:

1. To review the curriculum of the study program, in order to replace some subjects that do not match the profile of this study program;




2. The institution should recruit effective academic staff, to cover the workload of hours in the auditorium above 70%, in compliance with the legal acts in force;
3. The institution should as soon as possible put into use the electronic system of testing and evaluation of exams, as a tool for avoiding abuse, and increasing transparency;
4. The institution engages academic support personnel in the framework of teaching practices;



SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË CILËSISË SË PROGRAMIT

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. IV.BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

100


